

H Y L L I I D R I T Ë S

E PËRKOHSHME KULTURORE - LETRARE

120-VJETORI I LINDJES SË ÁT DONAT KURTIT

Aljula JUBANI

At Donat Kurti, martiri i “kangve në lavd të kombit” 5

Át Vitor DEMAJ

Disa reflektime mbi jetën e Át Donat Kurtit: “Kenia përballë ekzistencës” 9

Sabri HAMITI

“Vjollca e letrave shqipe” Át Donat Kurti simbas Át Zef Pllumit 21

Artan HAXHI - Alfred ÇAPALIKU

Donat Kurti – Dijetari i Kombit 25

Evalda PACI

Át Donat Kurti O.F.M. në një dimension mjeshtëror të shqipëruetit të tekstit biblik 32

Arben PRENDI

At Donat Kurti folklorist 41

Orjeta BAJA

Vështrim leksikor i veprës “Në rrugën e plepavet” të At Donat Kurtit 47

Mimoza PRIKU

Vitaliteti etnogjuhësor përmes veprës “Në rrugën e plepavet” të Át Donat Kurtit, O.F.M. 56

Edmond MALAJ Historia e Provincës Françeskane Shqiptare nën dritën e hulumtimeve të Donat Kurtit	62
Arbnora DUSHI Mbi praktikën e regjistrimit dhe të botimit të epikave nacionale: Palaj-Kurti dhe Elias Lönnrot	76
Majlinda BREGASI Treqind e gjashtëdhjetë e pesë rrëfime nga viti 1977 prej një barakeje të Shkodrës. Kujtimet e At Donat Kurtit nga perspektiva e akteve gjuhësore	91
Anisa KOSTERI - Bora LOGU Toponime dhe antroponime me vlerë në veprën e At Donat Kurtit	103
Ermira ALIJA Elemente të rëndësishme impaktesh kërkimore-shkencore që mundëson vepra e At Donat Kurtit	108
Erzen KOPERAJ “Gramatika shqype” e At Donat Kurtit dhe vendi i saj në gramatikat e hartuara në dialektin gegë	114
Ledri KURTI Provinca françeskane, një udhë drejt formimit të ndërgjegjes kombëtare dhe dijes së një kombi (II), përmes kontributit studimor e dëshmues, të At Donat Kurtit	121
Karmen LAZRI - Zamira SHKRELI P. Donat Kurti dhe terminologjia gjuhësore (Sipas përkthimit nga gjermanishtja të tekstit mësimor “Gramatika latine”, e filologut gjerman, August Scheindler)	144
Isida HOXHA Publicisti Kurti mes kolonave të shtypit dhe të kulturës	158
<i>GJUHËSI</i>	
Bardhyl DEMIRAJ Shfaqje të humanizmit kristian në tekstet biblike të ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut	165

STUDIME LETRARE

Kujtim M. SHALA

Tragjeditë e Fishtës

201

Bardh RUGOVA

Imazhi i shqiptareve/shqiptarëve në kulturën e
popullarizuar në botë

224

Fatbardha STATOVCI

Sistematizimi historik i letërsisë shqipe (autorë e vepra)

233

Muhamet HAMITI

Lufta dhe paqja në republikën e letërsisë

243

Nysret KRASNIQI

Histori dhe letërsi: Barleti e Bogdani

258

KONFERENCAT SHKENCORE

269

REDAKSIA E BOTIMEVE FRANÇESKANE

275

ARKIVI I HYLLIT

Fiset e Shqypnís së Verit

Lekët e Malsís: Kelmendi

280

BARDHYL DEMIRAJ

Shfaqje të humanizmit kristian në tekstet biblike të 'Mesharit' të Gjon Buzukut

Abstract

The object of the study and the results are already mentioned in the title of the article. Therefore, we are focused only on biblical texts from the 'Missal' of Gjon Buzuku (1555), which in their entirety undoubtedly occupy the largest space, in the first work published in Albanian, that we until today know.

By classifying the data obtained through intertextual analysis for a series of examples in biblical texts from the New Testament in this 'Missal', which clearly show occasional anomalies compare especially to the Vulgate (§§2-2.1), we hope to have developed an effective method of work and investigation (§4) whose implementation with philological precision enables a convincing positive response to the alternative approach (§§2. 2-2.2) that we have conveyed to the reader as regards to recognizing and deciphering the theme announced in the title, which deals with both the text of the 'Missal' itself and the theological-intellectual formation of its author (§1).

That this cleric – no matter how low was his position in the administrative hierarchy of the Roman Catholic Church – was absorbed in the course of Christian humanism as a moderate progressive movement in the theological-intellectual environment of his time is proven not so much by the preliminary interpretation of several passages at the colophon of the 'Missal' (§2. 3), but above all the evidence of intensive direct or indirect use from Buzuku of the Novum Instrumentum omne by the great humanist Desiderius Erasmus of Rotterdam, an edition that soon assumed the function of a guidepost in the further development of the Reformation in Europe and was simply renamed Textus Receptus (§3).

*This publication has enabled us to solve the enigma of the so-called anomalies in the Buzuku's 'Missal', which not coincidentally correspond to the Albanian editions of the New Testament in the culture of the Albanian writing of the 19th century. In any case, the facts that we have collected, analyzed and classified in this study hardly allow to be doubted, in the near or distant future, the natural conclusion that Buzuku reached, namely that he wanted – BuZ 90vc: *me u fëdigunë përse mujta me ditunë, me zbritunë pak mendetë e atyne qi të endiglonjënë* – to make an effort to enlighten the native Albanian*

believers to the best of his knowledge and conscience, thus creating an eternal masterpiece in the history of Albanian intellectual life, starting from the positions of Christian humanism of the time in which he lived.

1 Qerthulli problematik me diskutimin përkatës

Në këtë punim kemi sinjalizuar qysh në titull njëherësh si objektin e studimit ashtu edhe rezultatet e përfutuara në të. Prashtu jemi fokusuar vetëm në do tekste biblike të 'Mesharit' të Gjon Buzukut (1555), të cilat në tërësinë e tyre mëtojnë padyshim hapësirën më të madhe në veprën e parë, të botuar në kulturën e shkrimit shqip që njohim deri sot. Falë kësaj hapësire, përkatësisht organizimit të tyre në vepër, tradita filologjike dhe ajo historike-teologjike na mësojnë ta quajmë këtë libër, qoftë edhe si hipotezë pune, 'meshar', çka vjen me thënë se në rastin tonë nuk rrezikojmë assesit të biem në mëkat mortor, nëse e kundrojmë veprën e Buzukut edhe si ndërmarrjen e parë serioze në përkthimin e pjesëve të tëra nga Besëlidhja e Re dhe ajo e Vjetër në kulturën e hershme të shkrimit shqip. Por jo vetëm kaq: këtë realitet gjuhësor e trashëgojmë si kumt të dorës së parë prej autorit, birit të Bdekës dora vetë, në pasthënien e veprës, bash aty ku Don Gjoni përcjell në letër të bardhë motivin kryesor që e nxiti të fëdigej për të, sepse ja ashtu:

"...tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gjā të ëndigluom ën së Shkruomit Shenjtë, ën së dashunit së botësë sanë, desha me u fëdigunë, për sã mujta me ditunë, me zditunë pak mendetë e atyne qi të ëndiglonjinë." (Buzuku 90vc)

Përpos këtyre sqarimeve lidhur me objektin e studimit, që në pikëpamje metodike parakupton mirëfilli zhvillimin me akribi filologjike të një vargu analizash tekstuale përqasëse, shtojmë tash që me frazën nistore: "Shfaqje të humanizmit kristian...", kemi sinjalizuar qysh në titull rrjedhojën themelore që përcjell natyrshëm rezultati i vetë studimit në përgjithësi.

Asgjëmangut bëjmë fjalë këtu për rezultat të përfutur falë një perspektive të re këndvështrimi të veprës, parë kjo qoftë si teksti i parë shqip që i takon gjysmës së shek. XVI ashtu edhe, madje sidomos, si produkt i praktikave liturgjike me sfondin teologjik përkatës, i përfutur ky në një mjedis të veçantë kulturor-intelektual në kohën dhe për kohën kur 'meshari' u hodh në letër, madje arriti të shohë si i tillë edhe dritën e botimit.

Meqë me këtë çështje të cekur fillimisht kalimthi do të ndalemi

hollësisht në rubrikat në vijim, lejohej të theksojmë paraprakisht se ecim të sigurt në atë hulli që hapi thujse shtatë dekada më parë Eqrem Çabej në studimin e tij hyrës dhe njëherësh ballor mbi “Mesharin e Gjon Buzukut” (bl. I, Tiranë 1968: 1-101). Këtu Philologus Albaniae rreket të shpupurisë sadopak atë megjullnajë që mbështjell sot e gjithë ditën personalitetin e Buzukut dhe veprën e tij, duke i kumtuar lexuesit së pari një përvojë të natyrës universale, meqë:

“Në qoftë se fjala, që vepra e një shkrimtari është pasqyra më besnike e personalitetit të tij, është e vërtetë, atëherë edhe nga libri që kemi përpara duhet të nxjerrim diçka për autorin edhe në lidhje me nivelin e formimit të tij kulturor, me gjuhët që dinte e me shkallën e zotërimit të gjuhës amtare.” (Çabej 1968: 25)

Dhe është fakt, që në rastin e Don Gjon Buzukut, teksti i veprës së tij jet e mbetet sot e gjithë ditën i vetmi sinor orientues me mësuar diçka më shumë për personalitetin e autorit dhe formimin e tij teologjik-intelektual.

2 Anomali në tekstet biblike të “Mesharit” si nxitje për studim

2.1 Vëzhgime të derisotme

Sigurisht që Çabej nuk është as i pari dhe as i fundit studiues që ngre zërin lidhur me këtë premisë metodike (edhe) në studimet filologjike shqiptare, që cituam më lart. Dhe është fakt që, në historikun e studimeve mbi ‘Mesharin’ dhe Buzukun si autor i tij, ky qerthull tematik zë vend mirëfilli në do vëzhgime në dukje sipërfaqësore që i ndeshim qoftë edhe në mënyrë sporadike te një dorë studiuesish filologë të mëparshëm si Justin Rrota (1930, 1938), Mario Roques (1932), Namik Res(s)uli (1958), Selman Riza (1961), Martin Camaj (1960), Kolë Ashta (1996) sikurse syresh të kohës sonë, si Thoma Qendro (2010, 2014), Joachim Matzinger (2010, 2011, 2020), Omari (2010), Xhevat Lloshi (2020, 2021) etj.¹ Gjithsesi ky problem vjen e merr formë deri diku të plotësuar vetëm në hyrjen e edicionit kritik të ‘Mesharit’ (Tiranë 1968) me autor Eqrem Çabejn, bash në pjesën e saj të tretë me nëntitull “Vepra si përkthim” (bl. I, f. 25vv.), ku Çabej fillimisht konstaton, se:

“...teksti shihet se shkonte me mesharët që ishin në përdorim para Koncilit Tridentin, se në disa vise ka ndryshim me mesharët e

¹ Po mjaftohemi të citojmë këtu vetëm disa ndër studiuesit filologë klasikë të “Mesharit” të Gjon Buzukut, pra pa synuar assesit një paraqitje shteruese. Citimi i aradhës së pafund të autorëve dhe të studimeve mbi Buzukun do t’i shpërthente kufijtë e një studimi modest si ky yni që trajton një tematikë paksa të veçantë, përkatësisht të cekur ja ashtu kalimthi në studimet buzukiane. Gjithsesi nuk mund të linim pa cituar në punim prurjet e fundit serioze të studiuesve Thoma Qendro, Joachim Matzinger dhe Xhevat Lloshi.

mëvonë. Kështu më ndonjë vend ka ndonjë paragraf që u mungon këtyre mesharëve, më ndonjë tjetër mungon ndonjë paragraf që e kanë këta. Diku shihet një renditje ndryshe nga e këtyre mesharëve.

Duke e shqyrtuar tekstin shqip në një krahasim të vijuar me këto tekste, neve në gjendjen tonë të kërkimeve na del se pjesët e librit para Mesharit [deri në fol XXX – B.D] riprodhojnë përgjithësisht copat përkatëse latine e italiane... Në Meshar [pas fol. XXX – BD] shihet shpesh një largim nga teksti latin e njëkohësisht një pajtim me versionin italisht, si në lutje e uratë, si në copët biblike. **Këtu ndërkaq një tjetër gjë është që bie më fort në sy: Në pjesët e Biblës teksti shqip disa herë largohet nga teksti latin e italian, duke shkuar, për pjesët e Dhjatës së Vjetër, jo me Vulgatën, po me Septuagintën. Edhe në copët e Dhjatës së Re ai disa herë piqet jo me tekstin grek të Koinesë, po me ungjillin e traditës bizantine të greqishtes së re. Në këtë mënyrë ky tekst katolik përkon me ungjillin e Korfuzit e të Kristoforidhit, botime shqip që i përkasin kishës greke-ortodokse². Si do shpjeguar një fakt i tillë? Në këtë mes – edhe duke lënë mënjane eventualitetin e njohurive gjuhësore të autorit tonë në lidhje me greqishten – përjashtohet *a priori* mundësia që një libër i caktuar për besimtarë katolikë të largohet nga tekstet kanonike të kishës së Romës e të ndiqte drejtpërdrejt librat liturgjikë të kishës lindore.” (Çabej 1968: 27)**

Asgjëmangut, Çabej sinjalizon këtu një problem, pas gjase më të vështirë, me të cilin i është dashur të përballet shpesh, madje shumë shpesh, gjatë punës së mundimshme për transliterimin dhe tejshkrimin e “Mesharit”. Ndërkohë jemi të detyruar të pohojmë tash se zgjidhjet që ofron Çabej, sado të një natyre të përgjithshme qofshin, nuk i kapërcejnë sot për sot caqet e hipotezës, mbasi – së paku për tekstet biblike në fjalë – ai përsiat shfrytëzimin e mundshëm nga ana e Buzukut të do botimeve në një gjuhë sllave të jugut ase në sllavishten kishtare, duke iu referuar do burimeve, të cilat ai vetë nuk i dispononte, përkatësisht nuk i ishte dhënë mundësia të kryente mirëfilli analiza ndërtekstuale të natyrës përqasëse.

² Për hir të plotësisë së tekstit të Çabejt, po riprodhojmë këtu edhe fusnotën e tij në vepër: “Për të qenë të saktë, do shënuar se ka rasa, të vëna në dukje në botimin tonë, si LXXV/2 = LXXXV/2a §16, LXXVII = LXXXVII a §35, LXXX = LXXXb §11, LXXXI = LXXXIb 12, LXXXI/2 = LXXXI/2b §7, LXXXIV/2 = LXXXIV/2a §28, LXXXV/2 = LXXXV/2a §5, LXXIX/2 = LXXXIX/2a, Filipasit 2, 11), ku teksti i Buzukut piqet vetëm me modelin grek-sllav e me Kristoforidhin, ndërsa Grigori shkon me tekstin latin : dukuri e çuditshme, ku shkrimtari katolik i Veriut ndjek modelin bizantin, ai ortodoksi i Jugut vete pas tekstit të ritit romak. Për ne kjo gjë mund të spjegohet me rrethanën që ungjilli i Korfuzit që i vishet Grigorit, u hartua në rrethin e ishujve jonikë, që ka një popullësi vise-vise katolike, dhe kështu do të ketë shkuar pas ndonjë teksti grek, caktuar për besimtarë katolikë.” (Çabej 1968: 27, shën. 5)

Kështu, sipas tij: “Marrja nga burimet e greqishtes në çdo rasë nuk mund të ketë qenë ndryshe veçse me një rrugë indirekte. Në këto rrethana çështja gjen spiegimin e saj të natyrshmin, po të mendojmë që burimi i pandërmjemë ka qenë ndonjeri nga shkrimet sllave jugore të Bosnjes, Dalmacisë e Kroacisë. Këto, edhe pse ishin të ritit latin, vijonin traditën bizantine të sllavishtes së vjetër kishtare. Ky mendim, në të cilin kishim arritur na vetë me një rrugë thjesht induktive, nëpërmes të krahasimit të këtij teksti me përkthimet e Biblës në të tjerë gjuhë, gjeti pastaj një [f. 28] provë reale. Në botimin e një libri lutjesh kroatisht të shekullit të XIV., prej Raguze, e të një psalteri të shekullit të XV. po të këtij qyteti, nga ana e F. Francevit, botim që e dimë vetëm nga një recension i M. Rešetarit (Slavia, XIV, 244 vv.), botuesi ka vënë re se teksti sllavokishtar pak nga pak u kthye në gjuhën popullore dhe u ndreq prapë e prapë sipas tekstit zyrtar latin. Në këtë mënyrë më në fund, pas një vargu të gjatë kopistësh, lindnë këto monumete, në të cilat gjuha është gati krejt popullore, po me gjith’atë edhe në tekstuacion edhe në disa forma gjuhësore janë ruajtur gjurmë të dukshme edhe nga të përkthimit sllavokishtar prej greqishtes edhe nga të gjuhës sllavokishtare. Në recension të tij, Rešetari pranon për shumicën e rasave të tilla gjurmë të modelit të vjetër glagolit në këto tekste. Me gjith’atë ai shtron përpara mundësinë që përjashtimisht ndokush të ketë përkthyer diçka drejtpërdrejt prej latinishtes, po që prapsepapë, për ndonjë arsye, të ketë marrë parasysh edhe ndonjë tekst të vjetër, prej të cilit në këtë mënyrë ka mundur ndonjë gjurmë e tillë të kalojë nga teksti glagolit edhe në këtë përkthim që u bë nga latinishtja, i cili s’ka asnjë lidhje me tekstin glagolit as me redaktimet latine të popullarizuara. Shtojmë se e para pjesë e këtij botimi të çmueshëm, Libri i Lutjevet, përmban një *Officium beatae Mariae virginis* (Oficije blažene djeve Marije) të mbarimit të shekullit të XIV. ose të fillimit të XV-it. Ai piquet kështu në përmbajtje me pjesën e parë të librit shqip dhe mund të jetë modeli ose një nga librat fetare sllave që ka pasur për model autori shqiptar në hartim të veprës së tij....” (Çabej 1968: 27f.)

Për studiuesin e sotëm nuk është vështirë që pas leximit të kujdesshëm të gjithë këtij pasazhi të vijë në një përfundim paraprak se këto përsiatje të Çabejt, të përfutuara me rrugë thjesht “induktive” sot as mund t’i tumirim e as mund t’i hedhim poshtë patjetër, meqë nuk sendërtohen prej tij me shembuj konkretë prej ndonjë botimi gjegjës në njërën ndër gjuhët sllave të jugut ase në sllavishten kishtare, pra vështirë se mund të përcjellim këtu si argumente pozitive gjykimet dhe përsiatjet e tij ndaj çështjes në fjalë³.

³ Gjithsesi kjo çështje, së cilës do t’i përkushtohemi në një studim të ardhshëm, nuk mund të konsiderohet asses si e ezauruar njëherë e përgjithmonë. Ndër studiuesit që kanë mbajtur parasysh në studimet e tyre marrëdhëniet e mundshme të “Mesharit” përkatësisht të autorit të saj me shkrimet liturgjike sllavo-kishtare në kohën e vet dallojmë këtu sidomos studimet

Prashtu vijmë natyrshëm në një përfundim paraprak, që qerthulli tematik i parashtruar më lart mbetet ende një fushë e patrajtuar sa e siç duhet, për të mos thënë e lënë virgjër deri sot në studimet mbi personalitetin e Buzukut dhe veprën e tij, meqë, edhe në qoftë se është hedhur ndërkohë në debat, studiuesit janë mjaftuar me do konsiderata të përgjithshme, duke rrokur në to sipas rastit:

- 1) aftësitë dhe kapacitetet intelektuale, gjoja (më se) të diskutueshme të Don Gjon Buzukut si autor dhe pjesëtar i klerit të thjeshtë shqiptar në Kishën Katolike Romane e me një formim teologjik që, për ndokënd lënka shumë për të dëshiruar⁴;
- 2) zotërimin jo të mjaftueshëm nga ana e Buzukut të njëres apo tjetres gjuhë liturgjike në rrethet klerikale-intelektuale, ku bënte pjesë, sipas rastit: të latinishtes, të italishtes dhe/ose të ndonjërës prej gjuhëve sllave të Ballkanit (përgjatë bregdetit dalmat, në Bosnje e Mal të Zi, etj.), ndërkohë që qasjet ndaj ndonjë gjuhe tjetër biblike-liturgjike si p.sh. greqishtja e vjetër, ajo bizantine-kishtare deri edhe greqishtja e re janë një opsion që sipas mendimit të përgjithshëm do lënë më mirë jashtë vështrimit⁵;
- 3) sikurse edhe shkallën deri diku të pamjaftueshme të zotërimit të shqipes si gjuhë e traditës së vonë kishtare e pak ase aspak të lëvruar, sidomos në liturgji.⁶

2.2 Qasje alternative në studim

Pa dashur e pa synuar assesitë të përdorim bodecin qoftë ndaj aftësive intelektuale dhe formimit teologjik të lëvruarit më të hershëm të shkrimit shqip (§2.1, pikat 1 dhe 2), të cilat për mendimin tonë duhen riparë e rishqyrtuar me më shumë kujdes, ashtu edhe ndaj ndonjë rezerve paksa të nxituar lidhur me shkallën e zotërimit të shqipes prej tij, përkatësisht me zhdërvjelltësinë e stilit të përkthimit shqip në vepër (§2.1, pika 3), shpresojmë të kemi gjetur një qasje alternative bindëse lidhur me njohjen dhe studimin e ‘Mesharit’ në kuadrin e qerthullit tematik në fjalë, ku sipas Çabejt duhet doemos të “...përfashtohet *a priori* mundësia që një libër i caktuar për besimtarë katolikë të largohej nga tekstet kanonike të kishës së Romës e të ndiqte drejtpërdrejt librat

solide të Camajt (1960) dhe të Matzinger-it (2010, 2011, 2020). Hollësisht për to Omari 2010: 129ff. Mendime të ngjashme hedh së fundi për diskutim – me rezervat përkatëse – edhe Lloshi 2020, kur merr në analizë ndonjë përbashkësi që i rezulton në përjashtjen e ndonjë vendi të ‘Mesharit’ të Buzukut me gjejësin përkatës në një meshar kroat të vitit 1483, i cili nuk haset në tekstin e *Vulgata-s* (sh. më poshtë shën. 22).

⁴ Larg kufijve të etikës profesionale operon Riza 1961, [ribot.] 2004: 267vv.

⁵ Ndër të tjerë Çabej 1968: 25vv.

⁶ Sidomos Riza 1961, [ribot.] 2004: 267vv.

liturgjike të kishës lindore.” (Çabej 1968: 27)

Për hir të përmasave modeste që rrok një punim i kësaj natyre, si ky yni – e me shpresë se do të nxisim një ndërmarrje ballore të nevojshme në një të ardhme sa më të afërt –, jemi përqendruar në hulumtim kryesisht në do anomali që kemi mundur t’i qëmtojmë në ‘Meshar’ për një numër tekstesh biblike që i takojnë *vetëm* Besëlidhjes së Re, të cilat dëshmojnë dukshëm shmangie sidomos me tekstin latinisht paratridentin të *Vulgata-s* (= *Biblia Sacra Vulgata*), si tekst klasik i Shkrimit të Shenjtë, i kanonizuar si i tillë në Kishën Katolike Romane e që përcjell në shekuj pandërmjetshëm variantin e përkthyer latinisht të Shën Hieronimit (shek. IV/V e.j.).⁷

Pikënisjen tonë në hulumtim e nxiti gjithsesi vëzhgimi i Çabejt dora vetë, sipas të cilit këto shmangie, më saktë anomali në ‘Meshar’ në përjasje me tekstin e *Vulgata-s* përkujtojnë – pas gjase jo rastësisht – me tekstet biblike shqip në shek. XIX, bash me Biblën e Korfuzit (Meksi & Gjirokastriti 1824, 1827) dhe me atë të Kristoforidhit (gegnisht 1866; 1872; toskërisht 1879; etj.). Janë pikërisht këto rrethana që mundësojnë tash një qasje alternative sa solide aq dhe të verifikueshme me analizat tekstuale-filologjike përkatëse në veprën e Buzukut.

Në sythimin e një metodike pune sa më të përshtatshme në hulumtim duan mbajtur gjithsesi parasysh kushtet kulturore-historike dhe diskursi teologjik-intelektual që rrokin potencialisht Kristianitetin Perëndimor përgjatë shek. XVI-XIX e për rrjedhojë edhe traditën e përkthimeve shqip të Shkrimit të Shenjtë ase të pjesëve të tëra të tij përgjatë kësaj periudhe. Janë pikërisht këto rrethana që mund a duhet të kenë ndikuar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi edhe formimin teologjik-intelektual të Buzukut, duke mundësuar kështu syzimin e qasjeve të reja alternative edhe në shqyrtimin e anomalive në fjalë në ‘Meshar’.

Parë nga kjo perspektivë lejohemi të skicojmë fillimisht dy sinorë orientues që në pikëpamje metodike bëjnë të mundur bashkërendimin e punës lidhur me zbërthimin e kësaj enigme që pikasi i pari Eqrem Çabej e që ka të bëjë kryesisht me ato anomali që përjetojmë në tekste biblike të ‘Mesharit’, kur i përjasim me variantin burimor të *Vulgata-s* e që njëherësh na shfaqen si bashkëpërkime me përkthimet shqip të Besëlidhjes së Re në shek. XIX, të cilat sipas tij “i përkasin kishës greke-ortodokse” (§2.1).

⁷ Në studimin tonë kemi shfrytëzuar botimin e fundit (të pestin) shkencor, kritik të botuesve Robert Weber und Roger Gryson, që mund të konsultohet online në faqen zyrtare të Shoqërisë Biblike Gjermane (Deutsche Bibelgesellschaft – DBG): < <https://www.bibelwissenschaft.de/wissenschaftliche-ausgaben/vulgata> >

2.2.1 *Textus receptus* dhe përhapja e tij në kulturën e shkrimit shqip të shek. XIX

Së pari le të mbajmë parasysh që përkthimet shqip të Besëlidhjes së Re në shek. XIX, që kanë për autorë Vangjel Maksin me Grigor Gjirokastritin (Korfuz 1824, 1827) dhe Konstandin Kristoforidhin (1866, 1872, etj.), janë autorizuar prej Shoqërisë Biblike Britanike e për Vendet e Huaja (British and Foreign Bible Society – BFBS), e cila deri në fund të shek. XIX – më saktë zyrtarisht deri në vitin 1904 –, kishte të unifikuar në përdorim si tekst të Besëlidhjes së Re variantin e njohur dhe të mirënjohur atëbotë, sikurse edhe sot e gjithë ditën, si *Textus receptus* (TR).

Textus receptus (= TR = teksti i pranuar, i mirënjohur – B.D.)

...është emërtimi i Besëlidhjes së Re greqisht, i përfutur në një numër botimesh të saj në Europë përgjatë shek. XVI-XVII e që erdhi e shërbeu si tekst bazë në përkthimet e Besëlidhjes së Re në gjuhët e popujve dhe të shtresave të ndryshme sociale të krishtera që përkrahën lëvizjen reformatore të Protestantizmit në Europë e gjetkë, një lëvizje kjo që u kurorëzua me përfutimin e kishave të ndryshme protestante, përkatësisht me shkëputjen e tyre përfundimtare prej autoritetit të Kurisë së Shenjtë të Vatikanit si instanca më e lartë administrative e Kishës Katolike Perëndimore të kohës. Shtojmë gjithashtu që pagëzimi me këtë emër i takon zyrtarisht botimit të Besëlidhjes së Re greqisht prej dy botuesve holandezë Bonaventura Elzevir dhe Abraham Elzevir (Leiden 1633), ndërkohë që teksti në vetvete së bashku me një numër variantesh gjegjëse, madje edhe i përkthyer në disa gjuhë të Europës, i takojnë një shekulli më parë (§2.2.2.). TR erdhi dhe e bori funksionin e vet zanafillës si i ashtuquajturit tekst burimor i Besëlidhjes së Re në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe thajse përfundimisht në shek. XX, kur, përpos zbulimit të dorëshkrimeve të reja të (më)hershme të Ungjijve dhe të Besëlidhjes së Re në përgjithësi, erdhën e u përmirësuan në vazhdimësi krahas analizave tekstuale kritike edhe metoda e rindërtimit të një teksti burimor, në rastin tonë të Shkrimit të Shenjtë.⁸

Siç cekëm më lart, pinjollë të TR – si varianti i dikurshëm themelor i Besëlidhjes së Re kryesisht për kishat protestante – janë padyshim edhe tekstet, në të cilat u mbështetën gjerësisht përkthimet gjegjëse shqip të shek. XIX, anipse për to nuk është thënë ende fjala e fundit⁹. Prashtu Xhevat Lloshi, studiuesi dhe biografi i njohur i botimeve të teksteve biblike shqip në atë shekull, përkatësisht i autorëve të tyre, na

⁸ Literatura shkencore-enciklopedike për këtë temë është shumë e pasur dhe çdo i interesuar mund t'i qaset shpejt, qoftë edhe nëpërmjet faqeve serioze në internet, ndër to: < <https://www.bibelwissenschaft.de/> >.

⁹ Këtë temë rrok së fundi në detaj edhe Hosaflook 2019: 61vv.

mëson për botimet greqisht-shqip të Besëlidhjes së Re (Korfuz 1824, 1827) me përkthyes Vangjel Maksin dhe Grigor Gjirokastritin, se pjesa e greqishtes është varianti protestant i botuar së pari në Gjenevë më 1638⁽¹⁾, bash ai i realizuar prej Μάξιμος Καλλιπολίτης (= Maximus Callipolites †1633)¹⁰, ndërkohë që vetë botimet u realizuan nën kujdesin e Shoqërisë Biblike Joniane (Ionian Bible Society) me seli në Korfuz¹¹.

Sa u përket botimeve të Konstandin Kristoforidhit, Lloshi syzon, pas gjase, me të drejtë, se ai duhet të ketë shfrytëzuar si model në përkthimet e veta versionin protestant anglisht të Mbretit Xhejms (*The Holy Bible*. London 1611⁽¹⁾)¹².

2.2.2 *Novum instrumentum omne si pararendës i Textus receptus*

Qasjen tonë alternative për qëmtimin, sistematizimin dhe interpretimin e përbashkësive që ndan teksti i ‘Mesharit’ të Buzukut (1555) me tekstet shqip të Besëlidhjes së Re në shek. XIX, të cilat në një mënyrë a një tjetër sendërtojnë së bashku pikërisht ato anomali që diktojmë në të në përjasje me tekstin e *Vulgata-s*, e mbështet fuqishëm si sinor i dytë orientues edhe rrethana, që në Perëndim në motin e Buzukut qarkullonte përpos tekstit të zyrtarizuar të *Vulgata-s* edhe varianti – siç lejohemi ta quajmë sot – burimor i vetë *Textus receptus*. Bëjmë fjalë këtu për tekstin greqisht-latinisht të Besëlidhjes së Re, i mirënjohur si *Novum Instrumentum omne* (Basel 1516⁽¹⁾, 1519⁽²⁾, 1522⁽³⁾, 1527⁽⁴⁾, 1535⁽⁵⁾) e me botues dhe përkthyes humanistin e madh Desiderius Erasmus i Rotterdemit (†korrik 1536).

Novum Instrumentum omne (= NIO = Almise krejt e re)

...konsiderohet me të drejtë si botimi i parë kritik i tekstit burimor greqisht të Besëlidhjes së Re në Perëndim. Është pikërisht ky tekst që përcjell variantin e kanonizuar të Kishës Bizantine Lindore (= *teksti i Koinesë* – E. Çabej; gjerm. *Mehrheitstext*) e që si i tillë dëshmon jo

¹⁰ Kështu, sipas Lloshit: “Versioni i vjetër shqip toskërisht i Korfuzit më 1827, me sa duket, nuk është bërë nga origjinali greqisht, por nga versioni i vjetër në greqishten e re, i cili e shoqëronte dhe të cilin e ka ndjekur fjalë për fjalë” (2012: 152). Të frytshme kanë qenë për shkruenin e këtyre radhëve bisedat dhe shkëmbimi i mendimeve me studiuesit Thoma Qendro dhe David Hosaflook, të cilët ai shfrytëzon rastin t’i falënderojë këtu rishtas për zemërsisht.

¹¹ Lloshi 2012 [: Përkthimi i Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit: 1819-1827. Kreu X – material në dorëshkrim i vënë në dispozicion nga autori – B.D.] Po ashtu, sipas tij, autorët e tekstit shqip, më saktë vetëm Vangjel Meksi mund e duhet të jetë mbështetur edhe në ndonjë variant të saj në një tjetër gjuhë si p.sh. në italisht (varianti i Diodati-t, Gjenevë 1607⁽¹⁾) deri edhe ndonjë në frëngjisht.

¹² Sipas Lloshit në bibliotekën private të Kristoforidhit janë gjetur (pas vdekjes) gjithashtu “Dhiata e Vjetër greqisht, Okxonio 1850, si dhe Dhiata e re greqisht, Kandavaigjis 1851” [Përkthimet e Kristoforidhit dhe Bibla e Mbretit Xhejms – material në dorëshkrim i vënë në dispozicion prej autorit – B.D.]

rrallë shmangie dhe anomali në përjasje me variantin e *Vulgata-s* (= *Biblia Sacra Vulgata* = BSV)¹³ së Kishës Katolike Romane, e realizuar në fund të shek. IV e fillim të shek. V e.j. si përkthim në latinisht prej dorëshkrimeve ekzistuese greqisht e hebraisht nga ana e Shën Hieronimit. Në kuadrin e lëvizjes reformatore humaniste të kohës për njohje dhe rikthim në trashëgiminë e kulturës dhe të mendimit intelektual të antikitetit, Erasmus-i iu 'rikthye' pikërisht burimeve greqisht të Besëlidhjes së Re që ishin në përdorim në Kishën Bizantine Lindore¹⁴, duke ndërmarrë po vetë edhe përkthimin e tyre në latinisht, anipse edhe këtu – përpos anomalive të rastit, që do t'i shqyrtojmë me hollësi më poshtë – përgjithësisht është përpjekur të ruajë në formë e në stil tekstin burimor të *Vulgata-s*.

Botimi i parë i NIO-s së Erasmus-it së bashku me katër ribotimet e përmirësuara në gjallje të vet gëzuan jehonë të madhe në qarqet teologjike-intelektuale të kohës, duke u bërë jo vetëm baza e botimeve në vazhdimësi të tekstit greqisht (dhe latinisht) të Besëlidhjes së Re, i cili erdhi e u pagëzua më vonë si *Textus receptus* (§2.2.1), por shërbeu shumë shpejt edhe si teksti model në përkthimet e Besëlidhjes së Re në gjuhët e ndryshme të Europës¹⁵, si p.sh. ajo në gjermanisht me autor Martin Luther-in (1522¹⁶), i cili u bë korifeu i lëvizjes reformatore të Protestantizmit në Perëndim, përkatësisht themeluesi i kishave protestante në Gjermani, Europë e në botë; ajo në italisht nga Antonio Brucioli (1530); etj.

Botimet greqisht dhe latinisht të tekstit të Erasmus-it vijuan rrugëtimin e tyre edhe pas vdekjes së tij. Dallojmë këtu sidomos botimet e radhës të Robert Estienne, i cili në botimin e pestë të Besëlidhjes së Re (1551) u shtoi krerëve të secilit libër të Biblës (= Stephanus-Bibel) edhe numërimin e paragrafëve përkatës, bash ashtu siç i ngjerojmë sot e gjithë ditën në çdo botim të saj modern.

¹³ Lidhur me tematikën e studimit tonë vërejmë që në vitin 1546, në kuadrin e Kundërreformës, Koncili Tridentin e shpalli tekstin e *Vulgata-s* si autentik dhe vendosi të ribotohej (në Löwen) një variant i ri mundësisht pa asnjë gabim redaksional e ortografik („quam emendatissime“). Ky variant i redaktuar, i njohur si *Vulgata Sixtina* pa dritën e botimit në vitin 1590, duke u zëvendësuar shpejt me të dytin e radhës, të ashtuquajturën *Vulgata Clementina* në vitin 1692.

¹⁴ Për realizimin e kësaj ndërmarrjeje Erasmus-i shfrytëzoi 7 dorëshkrime të Besëlidhjes së Re greqisht që u takonin shek. XII-XV. Zbulimet e dorëshkrimeve të mëhershme, sidomos sosh që u kryen në shek. XIX-XX bënë që të relativizohej autenticiteti i tekstit të NIO-s, i cili erdhi dhe e bori thujse tërësisht rëndësinë e vet në konkurrencë me botimet kritike të Besëlidhjes së Re greqisht të kësaj periudhe e sidomos në kohën tonë. Lexuesi i interesuar mund të pajiset vetë shpejt dhe mirë me informacion enciklopedik të dorës së parë në diskursin teologjik-kulturor të kohës sonë.

¹⁵ NIO u ndalua me vendim të Koncilit Tridentin në vitin 1559 – d.m.th. 4 vjet pas botimit të 'Mesharit' – duke kaluar si i tillë në *Index librorum prohibitorum* (1559), anipse Erasmus-i ia kishte kushtuar atë dikur vetë Papa Leo-s X, duke marrë po prej tij përgëzimet e rastit. Hollësisht Reusch 1883: *passim*; Shih ndër të tjera edhe linkun < https://de.wikipedia.org/wiki/Novum_Instrumentum_omne > (klikimi i fundit më dt. 23.09.23).

Për studimin tonë fitojnë interes të veçantë edhe përkthimi italisht i botimit të NIO-s (1530) sikurse i gjithë Biblës prej Antonio Brucioli-t në Venedik (1530-1532), si qyteti ku ai jetoi e veproi për rreth 40 vjet. Bibla e përkthyer prej tij përfundoi deri në vitin 1551 së paku 15 botime, një tregues ky më se domethënës për jehonën dhe interesin e madh që gëzoi në rrethet klerikale-intelektuale të rajonit¹⁶. Duke shfrytëzuar gjerësisht në studimin tonë këtë botim bashkërendojmë punën tonë me atë të një numri të konsiderueshëm studiuesish albanologë, të cilët përsiasin Venedikun me rrethina si vendi dhe zona kulturore ku mund a duhet të ketë qenë aktiv Gjon Buzuku dora vetë, ose ku së paku të ketë botuar veprën e tij¹⁷.

2.3 Ndërmjet humanizmit kristian dhe Protestantizmit. Rasti Buzuku

Në funksion të qasjes sonë alternative ndaj tematikës në fjalë që synon në instancë të fundit zgjidhjen e atij *puzzle-i* që bart në mote analiza tekstuale-filologjike e tekstit të ‘Mesharit’, ndjejmë të nevojshme të ndalemi thukët edhe në dy rrymat a grupimet që shoqërojnë diskursin teologjik-intelektual në Perëndim së paku prej fundit të dhjetëvjeçarit të dytë të shek. XVI kur brenda frymës humaniste të mendimit teologjik-intelektual erdhi e u kristalizua edhe ajo lëvizje reformatore, që në historinë ekleziastike të Kishës Perëndimore njihet e mirënjihet më fort si Protestantizëm, porë ky si refuzim tërësor, d.m.th. shkëputje pa kthim ndaj autoritetit të Kurisë së Shenjtë të Vatikanit, përkatësisht të pozicionit të Papës si mëkëmbësi dhe vijuesi i misionit të Jezu Krishtit në botën e krishterë. Sigurisht që në mungesë të formimit teologjik përkatës, por edhe falë literaturës mbresëlënëse historike-teologjike dhe kulturore-fetare, që gëlon sot gjithkund edhe në mediat dhe rrjetet sociale (elektronike), po mjaftohemi në këtë punim të përmendim

¹⁶ Fati i Antonio Brucioli-t mori rrokopujën në periudhën e fundit të jetës së tij në Venedik, më saktë prej vitit 1555 – d.m.th. në vitin e botimit të ‘Mesharit’ –, kur e ku u përndoq rregullisht prej zyrës së inkuizicionit, madje u detyrua të deklaronte se gjithçka që kishte shkruar e botuar i takonte turrës së druve. Për më tepër ai nuk kishte më të drejtë botimi pa lejen e zyrës së inkuizicionit në Venedik. U arrestua rishtas më 1558, meqë nuk iu bind urdhrat të inkuizicionit me shkruar me dorën e vet një libër, ku të demaskonte vetveten për heretizëm dhe shtrigani. Vdiq më 6.10.1566 nën arrest shtëpie dhe në kushte varfërie ekstreme. Me vendim të Koncilit Tridentin përkthimi i Biblës prej tij kaloi po ashtu, në vitin 1559, në *Index librorum prohibitorum*. Hollësisht Reusch 1883: 373. Shih edhe linkun: < https://en.wikipedia.org/wiki/Antonio_Brucioli > (klikimi i fundit më dt. 23.09.23).

¹⁷ Pa synuar të listojmë këtu mendimet e ndryshme në debatin gjithherë të hapur mbi vendin ku ka jetuar Buzuku, përkatësisht vendin e botimit të ‘Mesharit’, veçojmë këtu së fundi studimin e studiueses Lucia Nadin (2012 230vv.), e cila sjell argumente të natyrës kulturore-historike sikurse edhe tipografike që tumirin mendimin se Buzuku duhet të ketë qenë aktiv në Venedik, pikërisht aty ku duhet të ketë parë dritën e botimit edhe ‘Meshari’ i tij. Këto përsiatje i mbështet së fundi edhe Hosaflook (2019 55vv.), i cili rreket t’ia atribuojë personalitetin e Buzukut dhe veprën e tij lëvizjes reformatore protestante të kohës.

thjesht dhe vetëm rrethanën e mirënjohur, që botimi i NIO-s ndikoi në fakt fuqishëm në zhvillimin e lëvizjes protestante në fjalë, ndërsa vetë botuesi dhe përkthyesi i tij, Erasmus-i me do pasues të tjerë nuk iu bashkuan pa kushte kësaj lëvizjeje, çka vjen me thënë që ai nuk bëri pakt me korifenj të tillë të Protestantizmit si Martin Luther-i, etj., madje hyri në konflikt me ta¹⁸.

Synimi kryesor i Erasmus-it në realizimin e NIO-s ishte kryekëput ai humanist që mund ta quajmë klasik. Në diskursin intelektual të kohës ky synim sendërtohet prej tij në gjurmimin, njohjen dhe përvetësimin e tekstit greqisht të Besëlidhjes së Re, si tekst zanafillës në përjasje me tekstin e përkthyer (qysh herët) latinisht të *Vulgata-s*, anipse *Vulgata* gëzonte atëbotë autoritetin e tekstit të kanonizuar prej Kurisë së Shenjtë të Vatikanit, d.m.th. si burimi i parë i fjalës së Zotit. Prashtu, i bindur se teksti greqisht i Kishës Bizantine Lindore ishte i kryehershëm e si i tillë edhe i patëmetë, Erasmus-i syzoi t'i përcjellë mjedisit intelektual-klerikal në Perëndim pikërisht atë si tekst burimor, duke i shtuar pikërisht këtij teksti edhe përkthimin latinisht. Për më tepër, këtë botim Erasmus-i e konceptoi të përdorej thjesht dhe vetëm si libër pune qoftë për klerin ashtu edhe për besimtarin e thjeshtë, d.m.th. njeriun (*human*), në mënyrë që të mund të kuptonin më mirë vetë *Vulgata-n*. Prashtu, në kundërshtim me qëndrimin kategorik përjashtues që karakterizon lëvizjen protestante në kohën e tij e më pas, teksti latinisht i *Vulgata-s*, sipas Erasmus-it, do të vijonte të gëzonte të drejtën e primatit në Krishterimin Perëndimor, d.m.th. me u përdorur mirëfilli si tekst i kanonizuar edhe në liturgji prej Kurisë së Shenjtë të Vatikanit.

Tipar tjetër i humanizmit kristian të Erasmus-it është edhe përftimi i kontaktit të drejtpërdrejtë të besimtarit me Fjalën e Zotit, e sendërtuar kjo në Shkrimin e Shenjtë. Me këtë synim ai nuk mendonte se do të cenohej sadopak autoriteti i kishës apo i klerit, përkatësisht misioni themelor i institucionit të kultit në vetvete, të cilin ai e konsideronte si faktor vendimtar në ngjizjen dhe forcimin e besimit të krishterë tek individit. E ky synim do të arrihej, sipas tij, në rast se Shkrimi i Shenjtë do t'i përcillej individit në gjuhën e tij native, një kërkesë kjo që edhe në letërsinë albanologjike konsiderohet shpesh – por jo saktë! – si produkt i Lëvizjes reformatore të Protestantizmit në Europë.

Së fundi shtojmë si tipar të humanizmit të tij kristian edhe rëndësinë që i kushtoi Erasmus-i unitetit në Kishën Perëndimore edhe në kuptimin e ruajtjes së hierarkisë administrative që kurorëzohej me autoritetin e padiskutueshëm të Kurisë së Shenjtë të Vatikanit dhe të vetë Papës në krye të saj. Pra edhe në këtë pikë Erasmus-i nuk synoi të

¹⁸ Sh. ndër të tjerë Stupperich 1936: 11vv.; Bendiscioli 1950: 52vv.

shkonte aq larg, siç ndodhi në Lëvizjen Protestante, që e refuzoi këtë autoritet, duke nxitur njëherësh edhe lindjen e kishave protestante në Europë e në botë.

Janë pikërisht këto tipare themelore të frymës së humanizmit kristian në Europë në motin e Buzukut që shpresojmë të na ndihmojnë sadopak për t'u çliruar prej ndonjë paragjykimi që ende ngre krye, kur studiojmë 'Mesharin' dhe personalitetin e autorit si klerik sado i thjeshtë në hierarkinë administrative të Kishës Katolike Romane e që si i tillë hodhi në letër të bardhë një vepër të natyrës liturgjike në gjuhën e vet native.

Asgjëmangut, na mungon sot për sot çdo forcë argumenti, kur gjykojmë me praktikën "bardhë e zi" si 'Mesharin', ashtu edhe, madje sidomos, autorin e saj, të cilin e kundrojmë sipas rastit si zëdhënës i "botës së sanë të Arbënit" e deri si "pinjoll i devotshëm i Protestantizmit".

Ato pak kumte të natyrës individuale që arrijmë të qëmtojmë prej veprës na lejojnë tash të përsiasim së paku si hipotezë pune formimin humanist kristian të Buzukut, sa kohë që:

a) ai njih dhe mirënjeh Papën e Vatikanit dhe rolin e tij si mëkëmbës i Krishtit në botën e krishterë, duke falur në 'Meshar' – në pjesën e breviarit – dy lutje për shëndetin e tij, khs.

- BuM 18va: O ju gjithë shenjtë Papë e Konfessorë, lutī për në

- BuM 18vb: Ti të denjonesh, zotnë Papë e Apostojt me gjithë ordënit të shenjtësë Klishë ëndë shenjte religjon me ruojtunë e me konservuom, t̃y të lusmë neve ëndiglo.

b) Në pasthënie Buzuku shprehet lirisht për çka përgjeron dhe e ka për zemër: t'i përcjellë shqip besimtarit nativ të shqipes vetë Shkrimin e Shenjtë si 'të dashunit e botës sanë', që vjen me thënë të krishterë, duke i mësuar të njohë Zotin atij që e kërkon dhe e do me gjithë zemër, khs.:

- BuM 90vc: U Doni Gjoni, biri i Bdek Buzukut, tue ɥ kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gjā të ëndigluom ën sē Shkruomit shenjtë, ën sē dashunit sē botës së sanë desha me ɥ fëdigunë, për sā mujta me ditunë, me zditunë pak mendetë e atyne qī të ëndiglonjinë, përse ata të mundë mernë sā i naltë e i mujtunë e i përmishëriershim anshtë Zotynë atyne qī ta duonë ëm gjithë zemërë.

c) Së fundi, po në pasthënie Buzuku nuk mëngon t'i drejtohet po shqip grigjës së vet, duke e lutur të vijë më shpesh në kishë, bash si vendi që i mundëson kontaktin me Zotin dhe fiton prej tij shëlbimin shpirtëror së bashku me të mirat e kësaj jete, khs.:

- BuM 90vc: U lus ëmbas sodi mā shpesh të ɥini ëm klishë, përse ju kini me ggegjunë ordhëninë e Tinëzot. E atë në ëmbarofshi, Zotynë të ketë mishërier ëmbī ju. E ata qī ɥ monduonë djerie tash, mā mos u mondonjënë. E ju t ini të zgjiedhunitë e Tinëzot. E përherë

Zotynë kã me klenë me jũ, ju tue ëndjekunë të dërejtënë e tue lanë të shtrembënë. E këta, ju tue bãm, Zotynë ka me shtuom ëndër jũ, se të korëtë taj të ënglatetë djerie ën së vjelash, e të vjelëtë djerie ën së ëmbjellash.

A e mbështesin këtë hipotezë pune tonën anomalitë e 'rastit' që i ngjetrojmë në veprën e Buzukut? (§§2-2.1) Le të ndalemi konkretisht për këtë çështje në rubrikën në vijim:

3 Anomalitë 'e rastit' në *Novum Instrumentum omne* dhe në *Textus receptus*

Le t'u rikthehemi tash anomalive 'të rastit' në botimin e Erasmus-it, e për rrjedhojë edhe në TR, të cilat i cekëm thukët më lart (§§2.2.1-2) e që fitojnë rëndësi të dorës së parë në studimin tonë. Theksojmë së pari, se me to nuk kuptojmë assesi do shmangie në përzgjedhje fjalësh, frazash, madje edhe në stil që shfaqen në përkthimin e tij latinisht prej tekstit gjegjës të *Vulgata-s*. Andaj dallojmë këtu fillimisht dy grupime shmangiesh tekstuale që përcjellin dukshëm mungesa ase shtesa në tekstin greqisht-latinisht të botimit të Erasmus-it:

- 1) shmangie që i qëmtojmë vetëm gjatë përqasjes së tekstit të NIO-s (bashkë me TR) me tekstin e *Vulgata-s*; dhe
- 2) shmangie që dëshmojnë dukshëm largimin e tekstit të NIO-s (bashkë me TR) si prej tekstit të *Vulgata-s* ashtu edhe prej gjegjësit greqisht të *Koinesë*.

Këtyre dy grupimeve mund t'u shtojmë potencialisht një të tretë, duke rrokur këtu:

- 3) ndonjë shmangie sporadike që dëshmon afrim të tekstit të NIO-s me *Vulgata-n* e njëherësh largimin e tij prej tekstit të *Koinesë*.

Klasifikimi i këtyre anomalive në 2 + 1 grupime të ndryshme është më se i nevojshëm për t'u orientuar në hulumtim, meqë, ndërsa në grupimin e parë botimi i Erasmus-it luan thjesht rolin e ndërmjetësit në transmetimin e anomalive ekzistuese midis tekstit zyrtar të Kishës Bizantine Lindore dhe të atij të Kishës Perëndimore, në grupimin e dytë është vetë teksti i Erasmus-it, që përcjell anomali shtesë, duke u larguar kështu dukshëm prej të dyja varianteve themelore të Besëlidhjes së Re që kishin në përdorim të dyja kishat në fjalë. Grupimi i tretë, sado i rrudhur në numër mund të ketë të bëjë në një mënyrë a një tjetër me natyrën e dorëshkrimeve greqisht që kishte shfrytëzuar Erasmus-i e që ishin të shpërndara kryesisht në Perëndim.

Puna e Erasmus-it për botimin e tekstit të NIO-s

...njihet ndërkohë¹⁹, domethënë se në rastin tonë anomalitë e grupimit të dytë janë përfutur gjatë punës së tij intensive për botimin e variantit greqisht të Besëlidhjes së Re, meqë ai për realizimin e botimit greqisht u mbështet kryesisht në shtatë dorëshkrime greqisht me moshë relativisht të vonë (shek. XII-XV) e që qarkullonin kryesisht në Perëndim. Për më tepër faksin në tekstin e tij edhe do ndërhyrje dhe shtesa që cilësohen si të natyrës individuale dhe që plotësonin mungesat në dorëshkrimet greqisht që dispononte. Kjo rrethanë e bën tekstin e NIO-s të dallohet njëherësh prej dy varianteve atëbotë themelore të Besëlidhjes së Re: si prej tekstit të *Koinesë* (gjerm. [Byzantinischer] *Mehrheitstext*) të Kishës Bizantine Lindore ashtu edhe *Vulgata-s* së Kishës Katolike Perëndimore.

Parë nga kjo perspektivë, varianti greqisht-latinisht i Erasmus-it fiton tash një pozicion qendror në hulumtim, meqë është pikërisht *Novum Instrumentum omne*, përkatësisht varianti i pagëzuar më vonë si *Textus receptus* (1633), ai që mundi të mbijetojë motet, duke u botuar dhe përkthyer në shumicën e gjuhëve të Europës e kudo në botë, madje erdhi e u përdor si tekst kanonik edhe për Kishat Protestante së paku deri në fund të shek. XIX e fillimet e shek. XX.

4 Premisa metodike

Kontakti i Buzukut me njërin ndër botimet e NIO-s para viteve 1554-1555, qoftë ai edhe i përkthyer në një gjuhë të gjallë që flitej atëbotë në Europë, bëhet tash më afërmendsh, në rast se mbajmë parasysh që objekt qendror i studimit tonë janë pikërisht do anomali që bashkojnë ungji tekste biblike të Besëlidhjes së Re në 'Mesharin' e Buzukut me përkthimet shqip të saj në shek. XIX (§2.2.1.).

Për të kopsitur sistematikën e duhur në hetimin e anomalive në fjalë kemi sythuar e mbajtur parasysh do premisa metodike, të cilat po i radhisim më poshtë, si vijon:

- 1) Përparësi në hulumtim fitojnë fillimisht vetëm ato anomali që i diktojmë në tekste biblike të Buzukut, por që nuk parakuptojnë patjetër mangësi të një përkthimi fjalë për fjalë (*ad litteram*) ose të përafërt (*ad sensum*) me vendet përkatëse në tekstin e *Vulgata-s*. Interes paraqesin në këtë rast vetëm ato zbrazësi, shtesa deri edhe shmangie konceptuale që vënë në dyshim qartas vërtetësinë ose rregullsinë e përkthimit me pika referimi vendet përkatëse në tekstin e *Vulgata-s*.
- 2) Këto anomali përqasen në një hap të dytë me përkthimet shqip

¹⁹ Sh. ndër të tjerë Bruce & Ehrman 2005: 137vv.

të Besëlidhjes së Re në shek. XIX prej Meksit dhe Gjirokastritit (1824, 1827) dhe Kristoforidhit (1866, 1872, 1879), duke parë, nëse kemi këso rasash pika takimi, apo dallime mes sosh.

- 3) Anomalitë e qëmtuara gjatë përqasjes me tekstin e *Vulgata-s* i nënshtrohen në një hap të tretë përqasjes me tekstin e *Koinesë* së Kishës Bizantine Lindore, duke i klasifikuar ato në grupimet e cituara më lart (§2.2.2). Në këtë mënyrë fitojmë informacion të besueshëm për a) çfarë e largon tekstin e Buzukut me atë të *Vulgata-s* dhe njëherësh e afron atë me Tekstin e *Koinesë* së Kishës Bizantine Lindore, përkatësisht b) çfarë e largon tekstin e Buzukut me atë të këtyre dy varianteve themelore, por që potencialisht mund ta afrojë atë me tekstin e NIO-s (sikurse me TR).
- 4) Në hulumtim janë mbajtur parasysh vetëm ato botime të Besëlidhjes së Re që i paraprijnë fazës së fundit të Konkilit Tridentin, kur kaluan në *Index librorum prohibitorum* (1559) jo vetëm përkthimi italisht i Biblës prej Brucioli-t (Venedik 1530-1532...1551) por edhe vetë *Novum Instrumentum omne* me autor Erasmus-in e Roterdamit.
- 5) Parë nga këto perspektiva, nuk gabojmë në rast se fiksojmë tash qoftë edhe *ad hoc* si terminus post quem non vitin 1551. Bëjmë fjalë këtu për atë periudhë, kur në botimet e Shkrimit të Shenjtë nuk kishte hyrë ende në përdorim teknika e re e organizimit të krerëve të çdo libri me numërimin e paragrafëve përkatës²⁰, pra një rrethanë që përkon katërcipërisht me pasqyrimin e teksteve biblike në "Mesharin" e Buzukut, ku mungon numërimi në fjalë.

Së fundi shtojmë për sqarim, se me këtë ndërmarrje nuk mëtojmë assesi një krehje ballore të të gjitha teksteve biblike të Besëlidhjes së Re që rrok 'Meshari' i Gjon Buzukut, çka do t'i shpërthente caqet e një studimi modest ndaj tematikës së sinjalizuar qysh në titull. Gjithsesi shpresojmë të kemi përsiatur e syzuar një metodikë pune solide që mundëson bindshëm shqyrtimin e çështjes ndoshta më të vështirë lidhur me botimin filologjik të veprës së parë madhore në kulturën e hershme të shkrimit shqip e bashkë me të edhe me njohjen e personalitetit të autorit të saj, Gjon Buzukut, përkatësisht me formimin e tij teologjik-intelektual, sikurse edhe me vendin e tij në trashëgiminë e mendimit intelektual shqiptar në kohë e hapësirë.

²⁰ Është fjala për botimet e së ashtuquajturës *Stephanus-Bibel*, të përgatitura prej humanistit dhe reformatorit frëng Robert Estienne (= lat. Robertus Stephanus): < https://de.wikipedia.org/wiki/Robert_Estienne >

5 Klasifikim anomalish në copëza tekstesh të Besëlidhjes së Re në 'Meshar'

Vërejtje redaksionale:

- Premisat metodike, të rreshtuara më lart (§4) na lejojnë tash të zbresim drejt e në tekstin e 'Mesharit' të Buzukut. Tabela e mëposhtme rrok gjithsej 20 anomali të numëruara me shifra arabe (kol. 1 = N[umë]r[imi]) që kemi qëmtuar deri sot në copëzat biblike të teksteve të Besëlidhjes së Re (kol. 2), duke i përqasur ato me vendet përkatëse në gjashtë botime të ndryshme të saj (kol. 3), ndër të cilat katër i takojnë periudhës para 'Mesharit', ndërsa dy të fundit janë botimet shqip të shek. XIX. Në këtë kolonë kemi specifikuar sipas rastit vitin e botimit, sa herë që shembujt lidhen me njërin ose tjetrin ribotim prej të njëjtit autor dhe numrin e faqeve për botimet shqip. Lexuesi nuk do ta ketë aspak të vështirë të pjesëmarrë natyrshëm në përqasjen tekstuale ndërmjet shembujve të cituar vertikalisht (kol. 4). Kolona e fundit (nr. 5 = R[ezultati]) me shenjat algjebrike <+> dhe <-> përcjell sipas rastit bashkëpërkim ose mospërkim të tekstit të 'Mesharit' me njërin apo tjetrin botim të marrë në përqasje.
- Lexuesi është përditësuar ndërkohë me të gjitha këto botime, andaj kemi përdorur në kolonën nr. 3 qoftë edhe për arsye vendi shkurtimet me initiale përkatëse, si vijon:
 1. BuM = Buzuku, Gj.: 'Meshari' (1554/5)
 2. BSV = [Shën Hieronimi]: Bibla Sacra Vulgata (shek. 4/5 e.j.)
 3. NIO = Erasmus, D.: *Novum Instrumentum omne* (1516⁽¹⁾ [1519⁽²⁾; 1522⁽³⁾; 1539⁽⁴⁾])
 4. Bru = Brucioli, A.: *La Biblia...Il Nvovo Testamento di Christo Giesv Signore, et Salvatore nostro...* ([1530] 1532)
 5. Biz = *Teksti i Koinesë* i Kishës Bizantine Lindore
 6. M-Gj = Meksi, V. – Gjirokastriti, G.: *Dhjata e Re* (1824 [Matheu]; 1827)
 7. Kr = Kristoforidhi, K. (1866 [Katër Ungjillat], tosk.; 1872, geg.)
- Në pasqyrimin e teksteve të marra në analizë në njërin apo tjetrin botim të Besëlidhjes së Re (kol. IV):
 1. kemi vendosur në kursiv vendet përkatëse në tekst, duke e lehtësuar kështu përqasjen ndërtekstuale për secilin botim. Në botimin greqisht është përdorur këso rasash nënvizimi. Në ato botime, ku këto vende mungojnë është bërë markimi përkatës me anë të tri pikave të ndërkallura në kllapa katrore: [...].

2. Trepikëshi i pa markuar tregon thjesht dhe vetëm ndërprerje para ose prapa fjalive të gjata, sigurisht pa vështirësuar aspak leximin dhe kuptimin e tekstit si të tillë.

Le të ngjërojmë tash vetëm 20 raste anomalish që kemi mundur t'i qëmtojmë në 'Mesharin' e Gjon Buzukut, pra pa mëtuar assesi një vjelje shteruese, çka parakupton një punë intensive dhe me kohëzgjatje të konsiderueshme me tekstin²¹.

Nr.	Vendi në Bibël	Variante të Bes. e Re	Tekstet	R
1	Mt 6 1	BuM 42rb	E ëmbani mend mos e bani <i>të dërejtënë</i> taj përpara njerëzet, përse ju t ini pātë ën sish...	
		BSV	Adtendite ne <i>iustitiam</i> vestram faciat coram hominibus ut videamini ab eis alioquin...	+
		Biz	Προσέχετε τὴν <i>ἐλεημοσύνην</i> ὑμῶν μὴ ποιεῖν ἔμπροσθεν τῶν ἀνθρώπων, πρὸς τὸ θεαθῆναι αὐτοῖς...	-
		NIO (1516-)	Adtendite ne <i>elemosina</i> vestrā faciat corā hoibus ut spectemini ab illis.	-
		Bru	Gvardate à non fare la vostra <i>elemosina</i> in presenza degli huomini per esser veduti da loro...	-
		M-Gj 1824 25	a. Vështoni të mos bëji <i>eleisinë</i> tuaj përpara njerëzet, për të dukurë nd'ata, se ndë bëfshi ashtu...	-
		Kr 1866 12	Këqyrni mos me bāmun <i>limoshënë</i> tui përpara nierzish, qi të shifeni prei atyneve: sepse ndë qoft...	-
2	Mt 15 8	BuM 52va	Kÿ popullë <i>muo afëronenë, me gojë</i> e me buzë më ënderinë, e zemëra e tyne larg anshtë ën meje fort.	
		BSV	populus hic labiis me honorat cor autem eorum longe est a me	-
		Biz	<i>Ἐγγίζει μοι</i> ὁ λαὸς οὗτος τῷ στόματι αὐτῶν, καὶ τοῖς χεῖλεσίν με τιμᾷ, ἡ δὲ καρδία αὐτῶν πόρρω ἀπέχει11 ἀπ' ἐμοῦ.	+
		NIO (1516-)	<i>Appropinquat</i> mihi populus hic <i>ore suo</i> , & labijs me honorat, caeterum cor eorum procul abest a me	+
		Bru	Questo popolo <i>mi si appropinqua con la boca sua</i> , & con le labra mi honora: & il cuore loro è discosto molto da me.	+
		M-Gj 1824 89	Kij llao <i>afëronetë</i> tek meje <i>me gojë të ture</i> , edhe me nderon me buzë, e zemëra e ture është shumë larg ngā meje	+

²¹ Kufizimi i numrit të anomalive në gjithë-gjithë 20 syresh është pjesë e punës së derisotme filologjike me tekstin e 'Mesharit' në kuadrin e projektit afatgjatë "Digitales philologisch-etymologisches Wörterbuch des Altalbanischen (15.-18. Jh.)" < <https://www.dpwa.gwi.uni-muenchen.de/> >, domethënë se ato këto anomali janë një varg i hapur, që mund të shtohet e të plotësohet në të ardhmen.

		Kr 1866 42-3	Kyj populli <i>më afrohet me gojën e vet</i> , edhe më nderon me buzët, por zemëra atyneve ashtë lark prej meje.	+
3	Mt 20 7	BuM 39va/b	E ata i thanë: Përse kush nukë na muor ëndë punë. E u tha atyne: Ecëni edhe ju ëndë vënesh të teme, <i>e të kini ta qish të jetë pr arësye</i> .	
		BSV	dicunt ei quia nemo nos conduxit dicit illis ite et vos in vineam	-
		Biz	Λέγουσιν αὐτῷ, Ὅτι οὐδεὶς ἡμᾶς ἐμισθώσατο. ¹⁸ Λέγει αὐτοῖς, Ὑπάγετε καὶ ὑμεῖς εἰς τὸν ἀμπελῶνα, <u>καὶ ὁ ἐὰν ᾖ δίκαιον λήψεσθε</u>	+
		NIO (1516-)	Dicunt ei, quia nemo nos conduxit. Dicit illis. Abite & vos in vineam, & <i>quicquid fuerit iustum accipietis</i> .	+
		Bru	Essi gli dicono, perche nessuno ci ha condotti. Dice à quegli. Andate anchora voi nela vigna, & <i>ha[u]fete quello che sera giusto</i>	+
		M-Gj 1827 69	I thanë atij, se nukë na mbloi njeri. U thot' edhe ature: Haideni edhe juvet ndë vështë, <i>e ajo që të jet' e udhësë, do të mirri</i> .	+
		Kr 1866 57	I thon: “Sepse kurkush s’na kã zanun.” Iu thot: “Shkoni edhe ju ndë vesht, <i>edhe keni me matun ç’ka të jët me udhë</i> .”	+
4	Mt 20 22-23	BuM 88ra	(22) E tue ju përgjegjunë Jezu tha: Ju nukë dini qish ju lypëni. A mundë pini atë kelq qi u kam me pīm [...] ? E i thanë atf: Mundnjëmë. (23) E u tha atyne: Kelqinë qi u kam me pīm ju ta pini, [...] ma me ëndenjunë ëmbë të djathët e ëmbë të shtëmanktët, ata nukë përket muo me ua dhanë juve, por atyne qi t u jetë dhanë ën Atit tim.	
		BSV	(22) Respondens autem Iesus dixit nescitis quid petatis potestis bibere calicem quem ego bibiturus sum [...] Dicunt ei possumus. (23) Ait illis calicem quidem meum bibetis [...] sedere autem ad dexteram meam et sinistram non est meum dare vobis sed quibus paratum est a Patre meo.	+
		Biz	(22) Ἀποκριθεὶς δὲ ὁ Ἰησοῦς εἶπεν, Οὐκ οἴδατε τί αἰτεῖσθε. Δύνασθε πλεῖν τὸ ποτήριον ὃ ἐγὼ μέλλω πίνειν, ἢ τὸ <u>βάπτισμα ὃ ἐγὼ βαπτίζομαι βαπτισθῆναι</u> ; Λέγουσιν αὐτῷ, Δυνάμεθα. (23) Καὶ λέγει αὐτοῖς, Τὸ μὲν ποτήριόν μου πίεσθε, <u>καὶ τὸ βάπτισμα ὃ ἐγὼ βαπτίζομαι βαπτισθήσεσθε</u> ; τὸ δὲ καθίσαι ἐκ δεξιῶν μου καὶ ἐξ εὐωνύμων μου οὐκ ἔστιν ἐμὸν δοῦναι, ἀλλ’ οἷς ἡτοιμάσται ὑπὸ τοῦ πατρὸς μου.	-

		NIO (1516-)	(22) Respondens autem Iesus, dixit. Nescitis quid petitis. Potestis bibere calicem quem ego bibiturus sum, & <i>baptismate quo ego baptizor; baptizatori</i> . Dicunt ei. Possumus (23) Ait illis. Calicem quidem meum bibetis, & <i>baptismate quo ego baptizor; baptizabimi</i> , sedere autem ad dexteram meam & sinistram non est meum dare, sed quibus paratum est a Patre meo.	-
		Bru	(22) Et rispōdendo Giesu disse. Voi nō sapete quello che voi chieggiate. Potete voi bere il calice, che io ho à bere? & <i>essere battezzati del battesimo, del quale io sono battezzato</i> ? Essi dicono, possiamo. (23) Et dice à questi. Voi certamēte berete il calice moi, & <i>sarete battezzati del battesimo, del qual io sono battezzato</i> . Ma il sedere à la destra mia, ò à la sinistra mia, nō si appartiene à me à darlo, ma à chi egli è apparecchiato dal padre mio.	-
		M-Gj 1827 70	(22) Edhe Iisui u përgjegj, e i tha: Nukë dini se ç'kërkoni. Mundni të pini potirë që do të pi unë, <i>edhe pagëzimnë, që do të pagëzonem unë</i> , të pagëzoneni edhe juvet? I thanë atij: Mundjëmë. (23) E u thotë ature: Potirë tim do ta pini, <i>edhe pagëzimnë, atë që pagëzonem unë</i> , do të pagëzoneni, ma të rrini mb'anë të djathëtë time, edhe mb'anë të mëngjërë time, nuk' është imea t'u ap, po është për ata që u është bënë gati ngaa babai im.	-
		Kr 1866 58	(22) Por Iesui u përgjegj, e tha: "Nuk dini se ç'ka lypni; mundeni me pimun potirin ki kam me pimun un, <i>edhe me u pagëzumun me pagëzimin qi kam me u pagëzumun un</i> ? Ata i thon: "Mundena". (23) Edhe ai iu thot: "Potirin tem keni me e pimun, <i>edhe me pagëzimin qi paëzohem un</i> , keni me u pagëzumun; por me ndejtun prei së diathtës teme, edhe prej së rrëmaktes teme, nuk është puna eme me e dhanun, por kà me u dhanun atyneve qi është bamun gati për ata prei tim et.	-
5	Mt 25 13	BuM 88/1va	Bdini prā, përse ju nukë dini as ditën as orën <i>qi të vinjë i Biri i njeriut</i> .	
		BSV	Vigilate itaque quia nescitis diem neque horam[...]	-
		Biz	Γρηγορεῖτε ²⁹ οὖν, ὅτι οὐκ οἴδατε τὴν ἡμέραν οὐδὲ τὴν ὥραν, ἐν ᾗ ὁ υἱὸς τοῦ ἀνθρώπου ἔρχεται.	+
		NIO (1516-)	vigilate itaque quia nescitis diem neque horam, <i>in qua filius hominis ueniet</i>	+
		Bru	Vigilate adunque: perche voi non sapete ne il di, ne l'ora, <i>ne la quale verra il figliuolo de l'huomo</i> .	+
		M-Gj 1824 155-6	Rrini dha zgjuarë, se nukë dini ditën, as sahatnë, <i>nd'atë që vjen i bir' i njeriut</i> .	+
		Kr 1866 75	Rrini çutë prā, sepse nuk dini ditën, as orën, <i>kur vien i biri nierit</i> .	+

6	Mt 27 34	BuM 65va	E i dhanë tamblëthitë përzienë <i>me uthullë</i> me pīm. E si e kërkoi, z desh me e pītë.	
		BSV	et dederunt ei <i>vinum</i> bibere cum felle mixtum et cum gustasset noluit bibere	-
		Biz	ἔδωκαν αὐτῷ πλεῖν ὄξος μετὰ χολῆς μεμιγμένον· καὶ γευσάμενος οὐκ ἠθέληεν πλεῖν.	+
		NIO (1516-)	et dederunt ei <i>acetum</i> bibere cm felle mixtum et cum gustasset noluit bibere	+
		Bru	et dettogli bere <i>aceto</i> mescolato cō fiele, & gustā-dolo nñ volle bere.	+
		M-Gj 1824 179	I dhanë atij të pij uthullë trazuarë me vërer, e si e vuri ndë gojë, nukë duaj të pij.	+
		Kr 1866 86	: I dhān me pīmun ufëll trazuom bashkë me t'amëlth; por ai si e vūni ndë buzë, nuk deshti me pīmun.	+
7	Mt 27 35	BuM 65va	E tue pasunë vum ëmbë kryqt, danë petëkatë e tī, tue qitunë short përëmbī to përse të ëmbaronë ta qish thashunë ish klenë ën profetet, <i>tue thashunë: Danë petëkatë e mī, e përëmbī cohët teme shtinë short.</i>	
		BSV	postquam autem crucifixerunt eum diviserunt vestimenta eius sortem mittentes [...]	-
		Biz	Σταυρώσαντες δὲ αὐτόν, διεμερίσαντο τὰ ἱμάτια αὐτοῦ, βάλλοντες κλῆρον [...]	-
		NIO (1516-)	postquam autem crucifixerunt eum diviserunt vestimenta eius sortem mittentes, ut impleret quod dictum est per prophetam. <i>Diviserunt sibi uestimenta mea, & super uestam meam miserunt sortem.</i>	+
		Bru	Et havendolo crocifisso, divisono i suoi vestimenti, mettendo la sorte, à fin che si adempiesse quello che si è detto per la propheta. <i>Et si divisono i miei vestimenti, & messono la sorte sopra la veste mia.</i>	+
		M-Gj 1824 180	E si e kruqasnë atë, ndajtinë rrobat e tij, si shtunë shorte, që të paguhetë ajo që qe thënë ngā profiti: <i>I ndajtinë rrobat' e mia me vetëhe të ture e mbë rrobë time shtunë short.</i>	+
		Kr 1866 87	Edhe si e kryqëzūn, shtīn shortë, e dan petkat e atī; qi të mbushet ç'ka āsht thanun prej profetit: " <i>Dān petkat e mī mbë vehen e atyneve, edhe shtīn shortë mbi petkun tem.</i> "	+
8	Mk 9 24	BuM 79ra	U besonj, e ti, <i>Zot</i> , më ëndimo t pābesuomit tim.	
		BSV	credo [...] adiuva incredulitatem meam	-
		Biz	Πιστεύω, κύριε, βοήθει μου τῇ ἀπιστίᾳ.	+
		NIO (1516-)	Credo <i>domine</i> , succurre incredulitati meae	+
		Bru	Io credo <i>Signore</i> ; aiuta la mia incredulita.	+
		M-Gj 1827 144	besoj, <i>o Zot</i> , ndihmë mua ndë pabesllëk tim	+

		Kr 1872 84	Zot, mbesoj; ndimo-i pa-besënisë seme.	+
9	Lk 2 43	BuM 37va	E si u ëmbaruonë ditë e festësë ata me kthiem, ëmbet djalëtë Jezu ëm Jerualem, e s ju kujtuonë të përintë.	
		BSV	consummatisque diebus cum redirent remansit puer Iesus in Hierusalem et non cognoverunt <i>parentes eius</i>	+
		Biz	τὰς ἡμέρας, ἐν τῷ ὑποστρέφειν ²⁸ αὐτοῦς, ὑπέμεινεν ²⁹ Ἰησοῦς ὁ παῖς ³⁰ ἐν Ἱερουσαλήμ· καὶ οὐκ ἔγνω Ἰωσήφ καὶ ἡ μήτηρ αὐτοῦ·	-
		NIO (1516)	Diebus cum redirent remansit puer Iesus in hierusalem, & non cognouerunt <i>parentes eius</i>	+
		NIO (1519-)	Diebus cum redirent remansit puer Iesus in Hierosolymis, & nō cognouerūt <i>parentes eius</i>	
		Bru	& finiti i giorni, nei loro ritorno, rimase il fanciullo Giesu, in Ierusalem, & non sene accorsono <i>il padre & la madre sua</i>	-
		M-Gj 1827 188	...E si teliosnë ditë mbë të kthierë të tyre, Jisui diali mbeti ndë Jerusalem e nuk e kupëtoi <i>Iosefi, edhe mëm e tij</i>	-
		Kr 1866 160-1	...edhe si u marūn ditt mbë të këthymit e atynevet, diali Iesui mbeti mbrapa ndë Gjerusalem; edhe <i>Iosefi edhe e ama e atī</i> nuk e dijsnin	-
10	Lk 4 41	BuM 72va	E dahishnë dreqënitë ën shumë ën sish, tue thirë e tue thashunë: Ti je <i>Krishti Biri i Tinëzot</i>	
		BSV	exiebant autem etiam daemonia a multis clamantia et dicentia quia tu es [...] <i>Filius Dei</i>	-/+
		Biz	Ἐξήρχετο δὲ καὶ δαιμόνια ἀπὸ πολλῶν, κράζοντα καὶ λέγοντα ὅτι Σὺ εἶ ὁ <u>χριστὸς ὁ υἱὸς τοῦ θεοῦ</u>	+
		NIO (1516-)	Exibant autem & daemonia a multis clamantia & dicentia. Tu es <i>Christus</i> [...]	+/-
		Bru	Et partiuansi i demoni da molti, gridando, & dicendo. <i>Tu sei Christo figliuolo di Iddio.</i>	+
		M-Gj 1827 197	Edhe dhemonëtë dilë nga shumë e thërrisnë e thoshnë se ti je <i>Krishti i biri i Perëndisë</i> .	+
		Kr 1872 116	Edhe prei shumë vetësh delshin edhe djemën, tue gërthitun e tue thanë, se ti je <i>Krishti i Bir' i Perëndisë</i> .	
11	Lk 14 5	BuM 78rb	E ëmbasandaj tha atyne: T sillt ën jush, në i bie <i>agëri</i> [...] ëndë pust të shëtundenë, e aj të mos e ënxjerë atë ças?	
		BSV	et respondens ad illos dixit cuius vestrum <i>asinus aut bos</i> in puteum cadet et non continuo extrahet illum die sabbati	+/-

		Biz	καὶ πρὸς αὐτοὺς εἶπεν· τίνας ὁμῶν υἱὸς ἢ βοῦς εἰς φρέαρ πεσεῖται, καὶ οὐκ εὐθέως ἀνασπάσει αὐτὸν ἐν ἡμέρᾳ τοῦ σαββάτου	-
		NIO (1516-)	et respondens ad illos dixit, Cuius uestrum <i>asinus aut bos</i> in puteum cadet, & non continuo extrahet illum die sabbati	+/-
		Bru	Et rispondēdo à quegli disse. <i>L'asino, o il bue</i> , di quale di voi, cadde nel pozzo, & subito non lo caua il di del sabbato	+/-
		M-Gj. 1827 244	E u përgjegj mba ta e tha: Cilit nga juvet ndë i raftë ndë pus <i>gomari a kau</i> e nukë do ta nxjerë atë atë çast ndë ditë të shtunë?	+/-
		Kr. 1872 145	Mbasandaj u përgjegj e u tha atyne: Kujt prei jush t'i bierë <i>gomari a kau</i> ndë pus, edhe s'ka me e nxierë përnjherë për ditë të shtunë?	+/-
12	Jo 5 4	BuM 45vb	<i>Përse engjëlli i Tinëzot dirgjë ëndë një mot ëndë bërakët e turbullon ujëtë. E mā i pari qi ëmbrenda hīn si ish turbulluom ujëtë, ashtu aj shëndoshë ën qishdo sēmunde aj të kish.</i>	
		Vulgata	[...]	-
		Biz	Ἄγγελος γὰρ κατὰ καιρὸν κατέβαινεν ἐν τῇ κολυμβήθρᾳ, καὶ ἐτάρασσεν τὸ ὕδωρ· ὁ οὖν πρῶτος ἐμβὰς μετὰ τὴν ταραχὴν τοῦ ὕδατος, ὑγιὲς ἐγένετο, ὃς δὴποτε κατείχετο νοσήματι	+
		NIO (1516-)	<i>Angelus autem descendebat secundum tempus in piscinam, & turbabatur aqua. Et qui primus descendisset in piscinam post turbationem aquae, sanus fiebat a quo cumq. detinebatur morbo.</i>	+
		Bru	<i>Perche l'angelo del Signore discendeua in certo tempo ne la piscina, & turbaua l'acqua. Et il primo che fusse disceso dopo la turbanone de l'acqua, diu-eniua sano da qualunque infermita fusse preso.</i>	+
		M-Gj 1827 306	Sepse Engjëlli zbrit mbë një kohë ndë kolimbithrë e nakatos ujëtë, e cilido që të zbrit i pari mbë të pas të nd[ë]katosurit së ujit, shëronej nga çdo sëmunde që të ke mbajturë.	+
		Kr 1872 181	Sepse kohë mbë kohë sdrypte engjuli ndë banjët edhe përzieme ujëtë: cili të hynë prā mā përpara, mbas të përziemit ujit, bahei i shëndoshë prei çdo farë sëmunde qi hiqte.	+
13	VA 8 37	BuM 65/1vb	<i>E i tha Felipi: Ti në beson ëmbë Krishtnë Jezu me gjithë zemërë, të përket me u pagëzuom. E ju përgjegj tue thashunë: U besonj se Jezu Krishti anshtë Biri i Tinëzot.</i>	
		BSV	[...]	-
		Biz	[...]	-
		NIO (1516-)	<i>Dixit aut Philippus. Si credis ex toto corde. Licet. Et respondens ait. Credo filium dei ess lesum Christum.</i>	+

		Bru	<i>Et disse Philippo se tu credi con tutto il cuore, è bene Et rispondendo disse. Io credo Giesu Christo essere il figliuolo di Dio, &...</i>	+
		M-Gj 1827 405	<i>Edhe Filipi i thotë: ndë beson me gjithë zemërë, munt; edhe ai u përgjigj e tha: besoj se Jisui Krishti është i biri i Perëndisë.</i>	+
		Kr 1872 240	<i>Edhe Filipi tha: ndë besofsh me gjithë zemërë, mundesh. Edhe ai u përgjigj e tha: Besoj se Iesu-Krishti është i Bir' i Perëndisë.</i>	+
14	VA 9 6	BuM 83vb	<i>E aj tue u dridhtunë e tue u çuditunë i tha: Zot, qish do u të banj? E Zotynë i tha:...</i>	
		BSV	[...]	-
		Biz	<i>ἀλλὰ ἀνάστηθι καὶ εἰσελθε εἰς τὴν πόλιν. καὶ λαληθήσεται σοι τί σε δεῖ ποιεῖν...</i>	+
		NIO (1516-)	<i>Et tremens ac stupēs dixit. Domine, quid me uis facere ? Et dominus ad eum...</i>	+
		Bru	<i>Questo tremando: & stupendo disse. Signore che vuoi che io faccia? Et il Signore à quello...</i>	+
		M-Gj 1827 406	<i>E ai tuk e dre[dh]urë, e tuk e çuditurë tha: o Zot, çdo ti që të bëj unë? edhe Zoti i thot atij...</i>	+
		Kr 1872 241	<i>Edhe ai tue u dridhun e tue u habitunë tha : Zot qish do ti me bām unë? Edhe Zoti i tha: ...</i>	+
15	Rom 13 9	BuM 38vb	Mos ban adulterio, qi do me thashunë: mos veshte pr udhë të keqe me gruot të shoqit; mos ënvra; mos vidh; <i>mos dëshmo rëshim</i> ; mos dëshëro gjanë e tjerëvet; e në anshtë tjetërë ordhënë mā i madh se kÿ, anshtë me dashunë shoqnë e fqinjënë tande porsi vetëvetëhenë.	
		BSV	nam non adulterabis non occides non furaberis [...] non concupisces et si quod est aliud mandatum in hoc verbo instauratur diliges proximum tuum tamquam te ipsum	-
		Biz	Τὸ γάρ, Οὐ μοιχεύσεις, οὐ φονεύσεις, οὐ κλέψεις, [...] οὐκ ἐπιθυμήσεις, καὶ εἴ τις ἑτέρα ἐντολή, ἐν τούτῳ τῷ λόγῳ ἀνακεφαλαιοῦται, ἐν τῷ, Ἀγαπήσεις τὸν πλησίον σου ὡς σεαυτόν.	-
		NIO (1516-)	<i>Nō adulteraberis, nō occides, nō furaberis, nō falsum testimonium dices, nō cōncupisces, & si quod aliud praeceptū, in hoc sermo ne sūmarium cōprehendit.</i>	+
		Bru	<i>Non farai adulterio, non vcciderai, non ruberai, non dirai falso testimonio, non desiderai, & non se alcuno altro precceto, in questo parlare si richiude, cioe amerai il prossimotuo come te stesso.</i>	+
		M-Gj 1827 525	Sepse porsia: Mos kurvëro, mos vra, mos vidh, <i>mos apç marturi të rremë</i> , mos dëshërosh edhe ndonjë tjetër porsi, ndë këtë fjalë është për të rrijturë, të duaç gjitonë tënt si edhe vetëhenë tënde.	+

		Kr 1872 308	Mos kurvënosh, Mos vrasish, Mos viedhish, <i>Mos bājsh deshmī rrënē</i> , Mos dëshërojsh, edhe qish do tjetër urdhënë në qoftë se është në këtë fjalë i shkurohetë kryetë, do me thënë “Të dësh të afërminë tand porsì vetëhenë tande.”	+
16	1 Kor 11 24	BuM 57/1rb	...e tue pasunë dhanë hīr Tinëzot, e ënthey e tha: <i>Merri e ani</i> , se kÿ anshtë korpi em qì për jū <i>anshtë ëntheyem</i> ; e këta ju ta bani muo me më sjellë mend.	
		BSV	et gratias agens fregit et dixit [...] hoc est corpus meum pro vobis [...] hoc facite in meam commemorationem	-
		Biz	...καὶ εὐχαριστήσας ἔκλασεν καὶ εἶπεν, <u>Λάβετε, φάγετε</u> : τοῦτο μοῦ ἐστὶν τὸ σῶμα τὸ ὑπὲρ ὑμῶν <u>κλόμενον</u> τοῦτο ποιεῖτε εἰς τὴν ἐμὴν ἀνάμνησιν.	+
		NIO (1516-)	...& post. gratias egisset, fregit, & dixit. <i>Accipite, Edite</i> , Hoc meum est corpus, quod pro vobis <i>fragitur</i> ...	+
		Bru	...& disse, <i>Pigliate, & mangiate</i> , questo e il mio corpo, che per voi è <i>spezato</i> . Fate questo in mia commemorazione.	+
		M-Gj 1827 562	E si bëri efharisti e theu e tha: merri, hai; kyj është kurmi im, që do të <i>ipetë (ndë vdekëje) për juvet</i> këtë bëni për të kujtuarë tim.	+
		Kr 1872 330	...edhe si u fal ndersë theu, edhe tha: <i>Merrni e hani</i> : kyj është korpi em, qì <i>thyhetë</i> për ju; këtë bëni për kujtimnë tem.	+
17	Efes 6 12	BuM 81rb	Përse na nukë kemi me u përnuom kondra gjakut e mishit, por kondra krenëvet, kontra d mujtunet, kondra zotënivet shekullit e kondra zotënivet t erëtit <i>të këfī shekulli</i> , e kondra diekeqiavet qì kondra shpirtit janë për qiellt.	
		BSB	quia non est nobis conluctatio adversus carnem et sanguinem sed adversus principes et potestates adversus mundi rectores tenebrarum [...] harum contra spiritalia nequitiae in caelestibus	-
		Biz	Ὅτι οὐκ ἐστὶν ἡμῖν ἡ πάλῃ πρὸς αἷμα καὶ σάρκα, ἀλλὰ πρὸς τὰς ἀρχάς, πρὸς τὰς ἐξουσίας, πρὸς τοὺς κοσμοκράτορας τοῦ σκότους <u>τοῦ αἰῶνος τούτου</u> , πρὸς τὰ πνευματικὰ τῆς πονηρίας ἐν τοῖς ἐπουρανίοις.	+
		NIO (1516-)	Quoniam non est nobis lucta, adversus sanguinem & carnem, sed adversus principatus, adversus potestates, adversus mundi dominos, tenebrarum <i>saeculi huius</i> , adversus spiritalia astutias in coelestibus.	+

		Bru	...perche non habbiamo la pugna contro il sangue, & la carne, ma contro à principati, contro à le potesta, contro à signori del mondo, rettori de le tenebre <i>di questo secolo</i> , contro à le spirituali astutie, ne le cose celesti.	+
		M-Gj 1827 637	Sepse nukë kemi të lëftojmë nevet me mish, a me gjak, po me arira, me urdhënatë, me ata që kanë mbë dorë <i>këtë jetë</i> t' errurë, me shpirtërë të liga, e' errësë.	+
		Kr 1872 373	...sepse lufta juei s'është kundrë gjaku e mishi, por kundrë urdhënavet, kundrë pushtetevet, kundrë urdhënarëvet botësë t' errësinësë <i>kësaj jete</i> , kundrë shpirtënavet këqī ndë vendet të qiejvet.	+
18	Kol 1 14	BuM 82rb	Hi dashuni i tij gjī na per te kemi te shperblemite <i>per gjak te tij</i> e te liruomite e katet	
		BSV	in quo habemus redemptionem [...] remissionem peccatorum	-
		Biz	ἐν ᾧ ἔχομεν τὴν ἀπολύτρωσιν, [...] τὴν ἄφεσιν τῶν ἁμαρτιῶν	-
		NIO (1516-)	...in quo habemus redēptionem, <i>per sanguinē ipsius</i> , remissionē peccatorum	+
		Bru	...per il quale noi habbiamo la redentione, <i>per il sangue di quello</i> , remissione de peccati	+
		M-Gj 1827 651	Mpa të kemi të shpërblëritë <i>me anë së gjakut së tij</i> , të ndëjerit e fajevet.	+
		Kr 1872 381	Mb' atë kemi shpërbleminë <i>me anë të gjakut atī</i> , ndëjesën e fajevet.	+
19	Hebr 10 34	BuM 86/1va/b	Për të vërtetë juve u dhimbetë për të ënlidhunit, e ju përzutë me gazëmend të madh të grabitunitë e d miravet tuoje, ju tue njohunë me pasunë mā të mirë qandrë për të ëmbetunë <i>ëmbë qiell</i> .	
		BSV	nam et vinctis compassi estis et rapinam bonorum vestrorum cum gaudio suscepistis cognoscentes vos habere meliorem et manentem substantiam [...]	-
		Biz	Καὶ γὰρ τοῖς δεσμοῖς μου συνεπαθήσατε, καὶ τὴν ἀρπαγὴν τῶν ὑπαρχόντων ὑμῶν μετὰ χαρᾶς προσεδέξασθε, γινώσκοντες ἔχειν ἑαυτοῖς κρείττονα ὑπαρξιν ἐν οὐρανοῖς καὶ μένουσαν.	+
		NIO (1516-)	...cū gaudio accepistis, sciētes uos habere in vobis, potiorē substntiā <i>in cælis</i> metipsis ac manētē	+
		Bru	...perche & de miei legami hauete hauuto compassione, & sostenesti con gaudio le rapine de le vostre faculta, conoscendo che voi haueui in voi migliore sustantia <i>ne cieli</i> , & durabile.	+
		M-Gj 1827 425	Sepse pësua të bashkë me mua ndë hapset' e mia, e duruatë pa helm të rrëmbierit e pliaskavet suaj sepse e diji që qini të pasurë më mirrë ndë qiell, të vetëhesë suaj, e të pa tundurë.	+

		Kr 1872 425	Sepse pësuetë bashkë me të lidhunat e mia, edhe pritët me gëzim të rrëmbyemen' e pasëjesë tuei, tue ditunë se keni për vetëhenë tuei <i>ndë qtejt</i> një më të mirë.	+
20	1 Jo 5 7-8	BuM 66 vb	(7) Përse janë trī qī dëshmonjënē <i>ëmbë qiell: Ati, Fjala e Shpirti shenjt; e këta të tre janë një.</i> (8) <i>E tre janë qī dëshmonjënē ëmbë dhët; shpirti, ujëtë e gjaku; e këta të tre janë një.</i>	
		BSV	(7) quia tres sunt qui testimonium dant [...] (8) [...] Spiritus et aqua et sanguis et tres unum sunt	-
		Biz	(7) Ὅτι τρεῖς εἰσιν οἱ μαρτυροῦντες, [...] (8) [...] τὸ πνεῦμα, καὶ τὸ ὕδωρ, καὶ τὸ αἷμα· καὶ οἱ τρεῖς εἰς τὸ ἓν εἰσιν.	-
		NIO (1516-9)	(7) Quoniam tres sunt qui testimoniū dant, [...] (8) [...] spiritus, & aqua, & sanguis, & hi tres unum sunt.	-
		NIO (1522-)	7) Quoniam tres sunt qui testimoniū dant <i>in caelo: pater, sermo, & sp[irit] sanctus; & hi trēs unū sunt.</i> (8) <i>Et tres sunt qui testimoniū dant in terra: spiritus, & aqua, & sanguis, & hi tres unum sunt.</i>	+
		Bru	(7) perche tre sono quegli che danno testimonio <i>in cielo, il padre, il verbo, & lo spirito santo, & questi tre sono uno.</i> (8) <i>Et tre sono quegli che danno testimonio in terra, lo spirito, & l'acqua, & il sangue, & questi tre sono uno.</i>	+
		M-Gj 1827 778	(7) Sepse tre janë ata që marturisjënē <i>ndër qiell: Babai, Fjala edhe Shëjnti Shpirt, e këta të tre një punë janë.</i> (8) <i>Tre janë ata që marturisjënē ndë dhe: Shpirti, Ujëtë edhe Gjaku, e të tre mbë një janë.</i>	+
		Kr 1872 455	(7) Sepse tre jân ata qī dëshmojënē <i>ndë qiell: Ati, Fjala edhe Shpirti Shenjt, edhe këta të tre janë një.</i> (8) <i>Edhe tre jân ata qī dëshmojënē ndë dhet: Shpirti edhe Ujëtë edhe Gjaku; edhe të tre jânë mbë një.</i>	+

5.1 Vëzhgime plotësuese

- Shembulli 1: Teksti i 'Mesharit' përkon me atë të *Vulgata-s*, duke u larguar prej botimeve të tjera të Besëlidhjes së Re që janë marrë në analizë.
- Shembulli 2: Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, ku një pjesë teksti mungon, duke përkuar njëherësh me botimin e Erasmus-it (1516-) dhe botimet e tjera, ku është mbështetur ai (teksti i *Koinesë*) ose sosh që mbështeten në të.

- Shembulli 3: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, ku një pjesë teksti mungon.
- Shembulli 4: Teksti i 'Mesharit' përkon me atë të *Vulgata-s*, ku një pjesë teksti mungon, duke iu larguar kështu botimeve të tjera të Besëlidhjes së Re që kemi marrë në analizë.
- Shembulli 5: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2, 3): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, ku një pjesë teksti mungon.
- Shembulli 6: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2, 3, etj.): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, ku në vend të fjalës *uthull* përdoret *verë* (= lat. *vinum*).
- Shembulli 7: Teksti i 'Mesharit' përkon me atë të Erasmus-it dhe të botimeve të mëvonshme që kemi marrë në analizë, duke iu larguar njëherësh si tekstit të *Vulgata-s* ashtu edhe atij të *Koinesë*. Kemi të bëjmë këtu me një ndërhyrje shtesë të ndërmarrë prej Erasmus-it d.v., e cila u bart në vazhdimësi në të gjitha botimet e mëvonshme të Besëlidhjes së Re (TR).
- Shembulli 8: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2, 3, etj.): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*: emri *Zot* mungon.
- Shembulli 9: Rast i vështirë për t'u klasifikuar. Teksti i 'Mesharit': *të prindër* (= prindërit e tij) përkon njëherësh me ata të *Vulgata-s* dhe të Erasmus-it (NIO 1516, 1519, 1522, 1535, 1539, etj.): *parentes eius* (= prindërit e tij), duke u larguar qoftë prej tekstit të *Koinesë*: Ἰωσήφ καὶ ἡ μήτηρ αὐτοῦ (= Jozefi dhe mëma e tij), ashtu edhe prej botimeve shqip të shek. XIX që ndjekin po këtë tekst: M-Gj: *Iosefi, edhe mëm e tij*; Kr (1866): *Iosefi edhe e ama e atë*. Si rast të veçantë shmangieje ngjërojmë edhe vendin përkatës në botimin e Brucioli-t: *il padre & la madre sua*, ku emri i Jozefit zëvendësohet (si korrekturë ?) me *il padre* (= ati, babai).
- Shembulli 10: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2, 3, etj.): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, duke përkuar plotësisht me vendin përkatës (jo në botimin e parë dhe të dytë, por) në botimin e tretë të Erasmus-it (NIO 1522-), i cili prej këtij botimi pasqyron me besnikëri tekstin e *Koinesë*. Këtë korrigjim e ndjekin rregullisht botimet e mëvonshme (TR), përkatësisht ato shqip të shek. XIX.
- Shembulli 11: Në tekstin e 'Mesharit' mungon gjymtyra e dytë në frazën emërore me bashkërenditje: *agëri*[ose kau]*, të cilën e ndeshim gjithkund në botimet e marra në analizë, e që mund të interpretohet thjesht si lajthitje ose harresë e autorit gjatë përkthimit, në mos gjatë radhitjes së tekstit për shtyp. Përndryshe në gjymtyrën e parë kemi bashkëpërkim të plotë qoftë me *Vulgata-n* ashtu edhe me botimin e Erasmus-it: *asinus* [*aut bos*] (= gomari [ose kau]) sikurse me botimet

e mëvonshme të marra në shqyrtim, të cilat në këtë rast largohen rregullisht prej tekstit të *Koinesë*: *υἱὸς ἡ βοῦς* (= biri ose kau).

- Shembulli 12: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2, 3, etj.): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, ku i gjithë paragrafi mungon.
- Shembulli 13: E njëjta situatë si në shemb. 7: Teksti i 'Mesharit' përkon me atë të Erasmus-it dhe të botimeve të mëvonshme që kemi marrë në analizë, duke iu larguar njëherësh si tekstit të *Vulgata-s* ashtu edhe atij të *Koinesë*. Kemi të bëjmë këtu me një ndërhyrje tjetër shtesë, të ndërmarrë prej Erasmus-it që u bart në vazhdimësi në të gjitha botimet e mëvonshme të Besëlidhjes së Re (TR).
- Shembulli 14: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2, 3, etj.): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, ku i gjithë paragrafi mungon.
- Shembulli 15: E njëjta situatë si në shemb. 7 dhe 13: Teksti i 'Mesharit' përkon me atë të Erasmus-it dhe të botimeve të mëvonshme që kemi marrë në analizë, duke iu larguar njëherësh si tekstit të *Vulgata-s* ashtu edhe atij të *Koinesë*. Kemi të bëjmë këtu përsëri me një ndërhyrje shtesë të ndërmarrë prej Erasmus-it, e cila u bart në vazhdimësi në të gjitha botimet e mëvonshme të Besëlidhjes së Re (TR).
- Shembulli 16: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2, 3, etj.): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, ku ajo frazë mungon.
- Shembulli 17: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2, 3, etj.): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, ku i gjithë paragrafi mungon. Përkthimi i këtij paragrafi te Meksi – Gjirokastriti 1827 është tejet i lirë dhe i përmbledhur, madje edhe në përqasje me gjegjësin e pranëvendosur (kol. 1 = majtas) në greqishten e re në atë botim.
- Shembulli 18: E njëjta situatë si në shemb. 7, 13, 15: Teksti i 'Mesharit' përkon me atë të Erasmus-it dhe të botimeve të mëvonshme që kemi marrë në analizë, duke iu larguar njëherësh si tekstit të *Vulgata-s* ashtu edhe atij të *Koinesë*. Kemi të bëjmë këtu rishtas me një ndërhyrje tjetër shtesë të ndërmarrë prej Erasmus-it, e cila u bart në vazhdimësi në të gjitha botimet e mëvonshme të Besëlidhjes së Re (TR).
- Shembulli 19: E njëjta situatë si më lart (shemb. 2, 3, etj.): Teksti i 'Mesharit' largohet prej atij të *Vulgata-s*, ku ajo frazë mungon.
- Shembulli 20: Situata e ngjashme me shemb. 7, 13, 15, 18: Teksti i 'Mesharit' përkon me atë të Erasmus-it (prej botimit të vitit 1522) dhe të botimeve të mëvonshme që kemi marrë në analizë (TR), duke iu larguar njëherësh si tekstit të *Vulgata-s* ashtu edhe atij të *Koinesë*.

Kemi të bëjmë këtu me një ndërhyrje tjetër shtesë që Erasmus-it ka ndërmarrë në botimin e tretë të NIO (1522) e që erdhi e u bart në vazhdimësi në të gjitha botimet e mëvonshme të Besëlidhjes së Re (TR).

5.2 Klasifikimi i të dhënave

Siç përmendëm më lart (§5), paraqitja tabelare e teksteve biblike rrok 20 raste anomalish që kemi mundur të qëmtojmë në 'Meshar', duke i përqsasur me së paku gjashtë variante botimesh të ndryshme të Besëlidhjes së Re, të cilat ose i prijnë (4) ose e ndjekin atë (2) në kohë e hapësirë. Përfundimi i përqsasjes në fjalë së bashku me vëzhgimet plotësuese (§5.1) lejon tash të ndërmarrim me siguri klasifikime të rastit, duke u përqendruar kryesisht në grupimin e bashkëpërkimeve dhe shmangieve të atyre vendeve në 'Meshar' me tri variantet themelore që ka përjetuar botimi i Besëlidhjes së Re në Perëndim në shek. XVI-XIX (BSV, Biz dhe NIO/TR). Gjithsesi nuk kemi lënë jashtë vështirimit as botimet shqip të shek. XIX, të cilat në instancë të fundit përkojnë përgjithësisht me *Textus Receptus* (TR = NIO). Për arsye të natyrës kulturore-historike që lidhen (pa)ndërmjetshëm me formimin teologjik-intelektual të Buzukut dhe veprën u rrok në përqsasjen ndërtekstuale edhe botimi i mëhershëm i Besëlidhjes së Re prej Brucioli-t (Venedik 1532), me të cilin teksti i 'Mesharit' përkon në shumësinë e rasteve të marra në shqyrtim (18 prej gjithsej 20 në numër).

Asgjëmangut, 20 shembujt në fjalë lejohemi tash t'i rrokim së bashku në deri 5 grupe, që dëshmojnë lëkundje të mëdha në dendurinë e rasteve që karakterizon secilin syresh, ndërkohë që dy të fundit tumirin status të veçantë me nga një rast të vetëm:

1. BuM = Biz = NIO/TR, Bru, M-G, Kr ≠ BSV
Shembujt 2, 3, 5, 6, 8, 10, 12, 14, 16, 17, 19
Grupimin më të madh e sendërtojnë 11 raste, me të cilat 'Meshari' shmanget dukshëm prej variantit të kanonizuar të Kurisë së Shenjtë të Vatikanit (BSV), duke iu bashkuar si i tillë të gjitha botimeve të tjera që përkojnë me atë të Kishës Bizantine Lindore (Biz, Teksti i *Koinesë*) e nëpërmjet tij edhe botimit të radhës që realizoi Erasmus-i në gjallje të vet (NIO 1516-, dhe/ose 1522-), duke vijuar si i tillë në pinjollët e shumtë e të ndryshëm të *Textus receptus* (TR, në rastin tonë: Bru, M-G, Kr).
2. BuM = NIO/TR, Bru, M-G, Kr ≠ BSV ≠ Biz
Shembujt 7, 13, 15, 18, 20
Grupimi i dytë rrok gjithë-gjithë 5 raste, në të cilat 'Meshari' u shmanget dukshëm të dy varianteve burimorë (BSV dhe Biz),

duke ndjekur shtesat që ka ndërmarrë vetëdijshtë Erasmus-i në botimin e tij të parë ose të tretë (NIO 1616, 1622), duke vijuar si të tilla në pinjollët e shumtë, të ndryshëm e të mëvonshëm të *Textus receptus* (TR, në rastin tonë: Bru, M-G, Kr)²².

3. BuM = BSV ≠ Biz ≠ NIO/TR, Bru, M-G, Kr

Shembujt 1, 4

Në dy shembuj 'Meshari' afrohet me variantin burimor të *Vulgata-s* (BSV), duke u distancuar kështu qoftë me gjegjësin e *Koinesë*, ashtu edhe me ndjekësin e saj, botimin e Erasmus-it d.v. (NIO), të cilin pasuan besnikërisht botimet e mëvonshme *Textus receptus* (TR, në rastin tonë: Bru, M-G, Kr).

4. BuM = BSV = NIO/TR, Bru, M-G, Kr ≠ Biz

Shembulli 11

Në një rast të vetëm 'Meshari' përkon si me variantin burimor të *Vulgata-s* (BSB) ashtu edhe me atë të Erasmus-it (NIO) dhe me botimet e tjera të mëvonshme të *Textus receptus* (TR, në rastin tonë: Bru, M-G, Kr), duke iu shmangur së bashku variantit burimor të *Koinesë*.

5. BuM = BSB = NIO ≠ Bru ≠ Biz, M-G, Kr

Shembulli 9

Së fundi në një rast po aq të vetëm 'Meshari' përkon si me variantin burimor të *Vulgata-s* (BSB) ashtu edhe me atë të Erasmus-it (NIO), duke iu shmangur njëkohësisht si variantit burimor të *Koinesë*, ashtu edhe botimeve të mëvonshme të *Textus receptus* (TR, në rastin tonë: [Bru], M-G, Kr)

²² Në këtë grup mund të ndërkallim edhe një rast tjetër anomalie që pikasi i pari Lloshi (2020, 2021), kur përqaste sado përciptas tekstin e 'Mesharit' me një meshar kroat të vitit 1483 (me ribotime në vitet 1528, 1530) e, sipas tij, të dy u shmangen tekstit të *Vulgata-s* (shën. 3). Bëhet fjalë këtu për praninë e emrit *djalë* në Ungjillin e Shën Llukës (Lk 2 21) në tekstin e këtyre dy mesharëve, i cili mungon në tekstin e *Vulgata-s*, khs.: BuM 84rb: / Ënd atë mot, ëmbassi klenë ëmbaruom tetë dit me u përëm *djalëtë*, u grish emënitë e tī Jezu, porsī kle grishunë ën engjëllit parë se ish zanë ëndë bark./ kundrejt BSV: /et postquam consummati sunt dies octo ut circumcideretur [...] vocatum est nomen eius Iesus quod vocatum est ab angelo priusquam in utero conciperetur./ Po mjaftohemi paraprakisht të vëmë në dukje, se ky emër mungon edhe në tekstin e *Koinesë*, khs.: Καὶ ὅτε ἐπλήσθησαν ἡμέραι ὀκτὼ τοῦ περιτεμεῖν [... αὐτόν], καὶ ἐκλήθη τὸ ὄνομα αὐτοῦ Ἰησοῦς, τὸ κληθὲν ὑπὸ τοῦ ἀγγέλου πρὸ τοῦ συλληφθῆναι αὐτὸν ἐν τῇ κοιλίᾳ./ Përndryshe kjo fjalë është e pranishme në botimin greqisht-latinisht të Erasmus-it (NIO: gr. ...περιτεμεῖν τὸ παιδίον... : lat. ...circumcideretur puer...), duke vijuar rrugëtimin e saj edhe në botimet e mëvonshme të TR, përkatësisht në botimet shqip të Besëlidhjes së Re në shek. XIX. Gjithsesi, kemi të bëjmë këtu me një tjetër problem që duhet parë e trajtuar më vete (sikurse më lart shembujt Nr. 9 dhe 11). Një sinor orientues për një hulumtim të ardhshëm është padyshim referenca e Lloshit lidhur me tekstin burimor latinisht, ku është mbështetur përkthimi i mesharit kroat (1483), i cili "ndjek rreptësisht përmbajtjen e botimit të vitit 1474 në Milano *Latin editio princeps*".

Siç rezulton prej analizës ndërtekstuale përqasëse dhe klasifikimit të ndërmarrë më sipër për 20 copëza tekstesh biblike në 'Meshar' prej Besëlidhjes së Re, 16 raste, që përcjellin plot 80% të numrit të përgjithshëm, largohen prej variantit burimor latinisht të *Vulgata-s*, duke përkuar dukshëm me botimin e *Novum Instrumentum omne* të Erasmus-it, i cili shërben si urë lidhëse qoftë me tekstin burimor të *Koinesë*, ashtu edhe me variantet e mëvonshme të saj që rroken nën emblemën *Textus receptus* (TR), duke rrokur këtu edhe botimet shqip të Besëlidhjes së Re në shek. XIX. Ndër këto 16 raste, 5 syresh, d.m.th. 25% e numrit të përgjithshëm, përkojnë vetëm me tekstin e Erasmus-it dhe botimet e mëvonshme të *Textus receptus* që mbështeten tërësisht në të, duke u larguar kështu njëherësh edhe prej variantit tjetër burimor greqisht të *Koinesë*.

Ndërsa kjo rrethanë më lart përforcon edhe më shumë bashkëlidhjen e tekstit të 'Mesharit' me atë të Erasmus-it, vetëm dy raste, d.m.th. 10% e numrit të përgjithshëm, dëshmojnë të kundërtën, d.m.th. bashkëpërkim me *Vulgata-n* e njëherësh largim prej *Novum Instrumentum omne* (NIO) dhe *Textus receptus* (TR). Përndryshe në një rast të vetëm (shemb. 11) kemi mundur të izolojmë një situatë disi të pazakonshme, pikërisht atë ku teksti i 'Mesharit' përkon njëherësh me *Vulgata-n* dhe *Novum instrumentum omne*, duke u larguar prej variantit burimor të *Koinesë* si edhe botimeve të mëvonshme të *Textus receptus*. Në një tjetër rast po aq të vetëm (shemb. 9) qëmtojmë një tjetër konstelacion, pikërisht atë ku teksti i 'Mesharit' përkon me gjithë të tjerët të botuar në Perëndim, duke u larguar së bashku me ta prej variantit burimor të *Koinesë* (Biz). Këto katër raste të fundit, që kërkojnë hulumtim të mëtejshëm, nuk e tronditin assesi marrëdhënien e ngushtë që përjetojmë tash krejt natyrshëm midis teksteve biblike të Besëlidhjes së Re në 'Mesharin' e Gjon Buzukut me *Novum Instrumentum omne* të Erasmus-it e nëpërmjet tij edhe me tekstet gjegjëse në botimet e Meksit me Gjyrokastritin dhe ato të Kristoforidhit.

6 Përfundime

Me klasifikimin e të dhënave të fituara nëpërmjet analizave ndërtekstuale për një numër shembujsh në tekstet biblike nga Besëlidhja e Re në 'Meshar' që dëshmojnë dukshëm anomali tashmë jo të rastit në përjasje kryesisht me *Vulgata-n* (§§2-2.1) shpresojmë të kemi sythuar një metodë pune efikase studimi (§4), zbatimi me akribi filologjike i së cilës mundëson natyrshëm përgjigje pozitive bindëse ndaj qasjes alternative (§§2.2-2.2.2) që i përcollëm lexuesit lidhur me njohjen dhe zbrërthimin e atij qerthulli tematik që ngërthen qoftë teksti i 'Mesharit'

në vetvete ashtu edhe formimi teologjik-intelektual i autorit të tij, Don Gjon Buzukut (§1). Që ky klerik – sado i thjeshtë të ketë qenë atëbotë në hierarkinë administrative të Kishës Katolike-Romake – erdhi e u përthith në rrjedhën e humanizmit kristian si lëvizje progresiste e moderuar në mjedisin teologjik-intelektual të kohës, këtë e dëshmon jo aq interpretimi paraprak i do vendeve në tekstin e pasthënies së ‘Mesharit’ (§2.3), se sa, madje sidomos, dëshmitë e shfrytëzimit intensiv të drejtpërdrejtë ose të tërthortë prej Buzukut të *Novum Instrumentum omne* me autor humanistin e madh Desiderius Erasmus i Roterdamit, një botim ky që ngadhënjeu shpejt funksionin e sinorit orientues në zhvillimet e mëtejshme të Reformacionit në Europë, thjesht duke u ripagëzuar si *Textus receptus* (§3). Është pikërisht ky botim ai çelës magjik që na mundësoi zgjidhjen e enigmës së të ashtuquajturave anomali të ‘Mesharit, të cilat përkojnë tash jo rastësisht me botimet shqip të Besëlidhjes së Re në kulturën e shkrimit shqip në shek. XIX.

Asgjëmangut, faktet që mblodhëm, analizuam dhe klasifikuam në këtë studim vështirë se lejojnë të vihet në dyshim në një të ardhme sado të afërt apo të largët përfundimin e natyrshëm, të arritur në të, pikërisht se si Buzuku *deshi me u fëdigunë përse muji me ditunë, me zdritunë pak mendetë* e besimtarëve nativë të shqipes, duke realizuar kështu një kryevepër të amshuar në historinë e mendimit intelektual shqiptar, bash nga pozitë e humanizmit kristian të kohës, në të cilën jetoi.

LITERATURË E CITUAR

Ahrhelger, Martin

2008 Die Textgrundlage des Neuen Testaments. <www.martinahrhelger.de>

Ashta, Kolë

1996 Leksiku historik i gjuhës shqipe, bl. I. Shkodër.

Bendiscioli, Mario

1950 Humanismus und Katholizismus, në “Münchener Theologische Zeitschrift. Vierteljahresschrift für das Gesamtgebiet der katholischen Theologie”. München: Karl Zink Verlag, 2. Heft, f. 45-58

Brucioli, Antonio

1532 La Biblia...Il Nvovo Testamento di Christo Giesv Signore, et Salvatore nostro... Di greco tradotto in lingua Toscana, per Antonio Brucioli. Impresso in Vinegia, ne le case di Lucantonio Giunti fiorentino.

- Buck, August
 1963 Gab es Humanismus im Mittelalter? Në: "Romanische Forschungen" 75 (jan. 1), f. 213-239.
- Camaj, Martin
 1960 Il "Messale" di Gjon Buzuku. Roma.
- Çabej, Eqrem
 1968 "Meshari" i Gjon Buzukut, Bl. I-II. Tiranë 2014.
- Erasmus, Desiderius
 NIO Novum Instrumentum omne i Erasamus-it. Basel 1516⁽¹⁾, 1519⁽²⁾, 1522⁽³⁾, 1527⁽⁴⁾, 1535⁽⁵⁾, etj.
- Fisher, Alexander Achilles
 2018 Bibeltext / Textkritik (AT), në: "Das wissenschaftliche Bibellexikon im Internet (WiBiLex)". Deutsche Bibelgesellschaft: <<http://www.bibelwissenschaft.de/stichwort/15273/>>
- Hermann, Rudolf
 1954 Theologische Anmerkungen zum "Humanismusproblem", në: "Zeitschrift für systematische Theologie" 23 (3), f. 225-251.
- Hosaflook, David
 2019 Lëvizja Protestante te shqiptarët 1816-1908. Shkup
- Kristoforidhi, Konstandin
 1866 Katër Ungjillat e Zotit edhe Shëlbuesit Tynë Iezu Krishtit edhe Punët e Apostuivët, këthymun prej greqishtes Vietër shqip ndë gjuhë gegënishte prej Konstantinit Kristoforidhit, Elbasanasit. Konstantinopol. Stampuem për Bretaniken & të Hujën Shoqëninë e Biblës. Prei A. I. Bojagjian.
 1872 Dhiata e Re e Zotit edhe Shëlbuesit tynë Iezu-Krishtit, këthyem prej greqishtesë Vietër shqip prej Konstantinit Kristoforidhit, Elbasanasit. Konstantinopol. Ndë shtypë-shkronjë të Bojagjianit.
- Lloshi, Xhevat
 2012 Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit: 1819-1827, Onufri, Tiranë
 2020 Një vështrim tjetër për librin e parë shqip: Meshari i Buzukut dhe Meshari kroat, në: "Dita" dt. 18.10.2020.
 2021 Vështrime stilistike. Tiranë.
- Meksi, Vangjel & Gjirokastriti, Grigor
 1824 Ungjilli i Jizu Hrishtoit Zotit sene që na shpëtoi. Sikundrë shkruan Shënt Mattheua. Mbë di gjuhë greqishte edhe shqipe. Korfoi En ti tipografia tis Dhiokiseos.

- Meksi, Vangjel & Gjirokastriti, Grigor
- 1827 Dhiata e Re e Zotit sonë që na shpëtoi, lizu Hrishtoit 1827. Mbë di gjuhë do me thënë greqishte e dhe shqipëtarçe (nën kujdesin e Grigorit, kryepeshkopit të Eubeas). Korfoi En ti tipografia tis Dhiokiseos.
- Matzinger, Joachim
- 2010 Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2, në: Bardhyl Demiraj (Hg.), Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet, në: „Albanische Forschungen“ 29, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010, f. 451 v.
- 2011 Ein Beitrag zur Buzuku-Philologie: Die Anordnung der Heiligennamen in der Allerheiligenlitanei des altalbanischen Seelsorgehandbuchs („Missale“), në: „Zeitschrift für Balkanologie“ 47 (1), f. 81–96.
- 2020 Das erste albanische Alphabet bei Gjon Buzuku (1555) – ein paar Beobachtungen, në: Demiraj, Bardhyl (ed.), „Altalbanische Schriftkultur – aus der Perspektive der historischen Lexikographie und der Philologie der Gegenwart – Akten der 6. deutsch-albanischen kulturwissenschaftlichen Tagung (27. September 2019, Buçimas bei Pogradec, Albanien)“, në: „Albanische Forschungen“ 44. Wiesbaden: Harrassowitz, f. 205–219.
- Metzger, Bruce M. & Ehrman, Bart D.
- 2005 The Text of the New Testament. Its Transmission, Corruption and Restoration. (4th Edition). New York – Oxford: Oxford university Press.
- Nadin, Lucia
- 2012 Shqipëria e rigjetur. Zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shek. XVI – Albania ritrovata. Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell’arte del cinquecento veneto. Onufri. Tiranë.
- Omari, Anila
- 2010 Ndikimet sllave te Buzuku: Kontributi i Camajt, në: „Studime Filologjike“, nr. 3-4, f. 129-141
- Qendro, Thoma
- 2010 Të shkruomit shenjtë. Tiranë
- 2014 Fjalor i shqipes së Gjon Buzukut (me rreth 3200 fjalë, 350 emra të përveçëm dhe 260 fjalë e shprehje latinisht). Tiranë.

- Ressuli, Namik (ed.):
 1958 Il "Messale" di Giovanni Buzuku. Riproduzione e trascrizione. Città del Vaticano.
- Riza, Selman
 1961 Pesë autorët ma të vjetër të gjuhës shqipe. Tiranë (ribot. Në Riza « Vepra », bl. IV. Prishtinë 2004, f. 233-293).
- Robinson, Maurice A. & Pierpont, William G. (bot.)
 2005 The New Testament in the Original Greek Byzantine Textform. Chilton Book Publishing: Southborough, Massachusetts 2005.
- Roques, Mario:
 1932 Recherches sur les anciens textes albanais. Paris.
- Rrota, Justin
 1930 Monumenti më i vjetri Gjuhës Shqype. D. Gjon, Buzuku (1555). Shkodër.
- Salzmann, Bertram & Schäfer, Rolf
 2009 Bibelübersetzungen, christliche deutsche, në: "Das wissenschaftliche Bibellexikon im Internet (WiBiLex)". Deutsche Bibelgesellschaft: <http://www.bibelwissenschaft.de/stichwort/15285/>
- Schäfer, Rolf & Voss, Florian
 2008 Biblische Textforschung, në: "Einführung in die wissenschaftlichen Ausgaben der Deutschen Bibelgesellschaft". Deutsche Bibelgesellschaft: <http://www.bibelwissenschaft.de/stichwort/15285/>
- Stupperich, Robert
 1936 Der Humanismus und die Wiedervereinigung der Konfessionen. Leipzig: M. Heinsius Nachfolger.
- Victor, Ulrich
 2003 Textkritik – Eine Einführung, në: (bot. Victor – Thiede – Stigelin) „Antike Kultur und Neues Testament“. Basel: Brunnen Verlag, f. 171-252.
- Zamputi, Injac
 1986 Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqipe, në: "Studime filologjike" nr. 3, f. 185-204.
https://drive.google.com/file/d/1Mgapu9HOpQyT-eEf89ZSG_ow69uQl5Ea/view